



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 12 DHE 13 DHJETOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 12. I 13. DECEMBRA 2013. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për investimet e huaja,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike,
9. Zgjedhja e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
10. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
11. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o zaštiti i promovisanju zajednica i njihovih pripadnika u Republici Kosova,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji za reviziju u Republici Kosova,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Agenciji za zapošljavanje u Republici Kosova,
6. Drugo razmatranje o stranim investicijama,
7. Razmatranje izveštaja Komisije za budžet i finansije u vezi nadgledanja Zakona o javnim nabavkama u Republici Kosova,
8. Razmatranje izveštaja Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju u vezi nadgledanja sprovođena Zakona o javnim preduzećima,
9. Izbor četiri člana Nezavisnog saveta za nadgledanje civilne službe Kosova,
10. Izbor dva člana Nezavisne komisije za medije,
11. Predlog Parlamentarne grupe PDK za zamenjivanje jednog člana Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, životnu sredinu i prostorno planiranje.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e paraparë në 30 minuta, në emër të grupit pesë minuta, në emër të deputetit 3 minuta.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Sot dua të ngre një shqetësim, jo vetëm timin, por të shumë qytetarëve të Kosovës se çfarë ilaçesh po konsumojmë, çfarë produktesh medicinale po u ofrohen pacientëve tanë? A janë barnat që konsumojmë vërtet të licencuara? A janë ilaçet vërtet ilaçe? A ju ka ndodhur të blini barna në farmaci, t'i konsumoni ato me rregull dhe të mos japin kurrfarë efekti? A po ndodh që të konsumojmë barëra dhe ato të mos ndikojnë në shërimin, por nëpër keqësimin e gjendjes së pacientëve?

Pse po ndodh kjo, të nderuar kolegë deputetë?

Përgjigjen keni pasur mundësinë ta lexoni nëpër media ditë më parë, kur u arrestua Azem Lajçi, pronar i kompanisë 'Leka Med', profesor, biznesmen, profesor universitar në Departamentin e Farmacisë në Universitetin e Prishtinës.

Azem Lajçi, në laboratorin e tij 'Leka Med' po prodhonte barna pa licencë. Ai aty po falsifikonte barna, po prodhonte barna ilegalisht pa kurrfarë kriteri në kushte të mjera higjienike. Ai pastaj ato produkte ua shiste pacientëve tanë për përfitime personale. Për përfitime personale, Azem Lajçi, pacientëve tanë, në vend se t'u ofrojë barna, ilaçe, ai atyre po u shiste helm.

Rasti 'Leka Med' për mua u bë u bë edhe më shqetësues kur javën e kaluar në Komisionin për Shëndetësi raportoi drejtori i Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale, Arianit Jakupi, i cili tha se me rastin e arrestimit të Azem Lajçit, pronarit të 'Leka Med', gjatë inspektimit që i është bërë laboratorit të tij ilegal që po përdorej për falsifikimin e barnave, në çdo aparaturë dhe në hapësirat e 'Leka Med' është hasur në prezencën e baktereve të rrezikshme, ndër to edhe 'Staphylococcus albus'.

Në këtë ambient me baktere të rrezikshme, ndër të tjera, Azem Lajçi ka falsifikuar edhe pika AD, që u jepen fëmijëve pas lindjes për forcimin e eshtrave deri në moshën njëvjeçare.

Të nderuar kolegë deputetë,
Paramendoni, Azem Lajçi, fëmijëve tanë, në vend se t'u ofrojë barna për forcimin e eshtrave, ai atyre u ka shitur baktere të rrezikshme.

Në këtë ngjarje, apo krim monstruoz, anomalia më e madhe është se, me gjithë faktet e mbledhura nga AKPM-ja, Policia e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, pronari i 'Leka Med', Azem Lajçi, pas 5 ditësh qëndrimi në paraburgim lirohet.

Lirohet nga paraburgimi njeriu që, në vend të barnave, pacientëve u ka shitur baktere të rrezikshme. Ai tani i lirë edhe mund t'u ligjërojë studentëve në Departamentin e Farmacisë se si ka arritur ta mashtrojë shtetin, t'i mashtrojë pacientët dhe të gjithë të tjerët, sepse për të tjera nuk ka as nga të ligjërojë ai, për profesionalizëm jo, për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Prej LDK-së, fjalën e ka Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk jam njeri që dal ta shfrytëzoj këtë treminutëshin e deputetëve për të ngrehur çështje.

Deputetë të nderuar,

Kryetar i nderuar,

Jam jashtëzakonisht i shqetësuar si deputet me një karrierë të gjatë në këtë institucion dhe që kam qenë në krye gjithmonë, ose afër Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe e konsideroj buxhetin si një ligj më të rëndësishëm që deputetët e aprovojnë.

Ndërhyrja e kryeministrit para nja 10 minutave, meqë e ka sjellë një amendament që përfshihet në Ligjin për buxhetin, në aspektin institucional, profesional, politik për mua është shumë shqetësues.

Do ta merrni vesh më vonë se çfarë do të ndodhë, por unë do ta lexoj vetëm paragrafin e fundit, i cili thotë:

“Me miratimin e Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2014, raporti i dorëzuar nga Qeveria më 27 maj 2013, numër 144/13, në Kuvendin e Republikës së Kosovës konsiderohet i miratuar”. Është fjala për shitjen e Postës.

Në amendamentin më të detajuar figuron shitja 75% e Postës, 277 milionë.

Shitja bëhet me dokumente të tjera, me vendime të Qeverisë, ndërmarrjet publike, aprovuar nga Kuvendi, por jo me buxhet të Republikës së Kosovës.

Si deputet, të them edhe një herë, pak si profesionist, si politikan i profilizuar për çështje financiare dhe ekonomike, ndihem jashtëzakonisht i shqetësuar për atë çfarë po ndodh me ne.

Një herë na ka ndodhur në vitin 2011, ai neni i famshëm i katërt, e tash po përsëritet. Shtroj pyetjet: ku jemi, çfarë po bëjmë, ku po duam të shkojmë? Kjo nuk është në mënyrë legjitime, kjo është ndërhyrje. Ky është kamuflim. Ky nuk është seriozitet.

Kryetar, unë ju kisha lutur që ta ushtroni ndikimin, që të zhvillohen procedurat e duhura, secili me ligjin e vet dhe secili me vendimin e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca e ka fjalën, në emër të grupit.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar!
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Më 6 prill të vitit 2011, kryeministri Thaçi, Isa Mustafa dhe Behgjet Pacolli e nënshkruan marrëveshjen për dalje nga kriza e zgjedhjes së Presidentit.

Kjo zgjedhje atëbotë u shpall e paligjshme nga Gjykata Kushtetuese.
Për të gjithë ata që kanë harruar, marrëveshja në pikën e tretë të saj thotë se Ligji i zgjedhjeve duhet të reformohet dhe amandamentohet në një periudhë kohore ndërmjet 8 dhe 12 muajsh.

Sot, zonja dhe zotërinj, jemi më 12 dhjetor të vitit 2013. Kjo do të thotë që kanë kaluar 2 vjet e tetë muaj prej kësaj marrëveshjeje, apo së paku 1 vit e tetë muaj përtej afatit të paraparë me të. Ku janë tash këta liderë nënshkruar për t'ia shpjeguar popullit këtë mashtrim? Ku është sinjeriteti i tyre? Këto janë premtimet e pambajtura, por as të parat e as të fundit të këtyre liderëve politikë.

Në atë kohë, PDK-ja synonte ta kapërcente krizën duke e mbajtur pushtetin me çdo kusht, kurse LDK-ja arsyetohej se kështu po ia shkurtonte mandatin koalicionit qeverisës.

Po më kujtohet si sot një debat në televizion me Teuta Sahatqinë, menjëherë pas arritjes së marrëveshjes, e cila me një siguri të padiskutueshme më thoshte se këtë po e bëjnë që t'ia shkurtojnë Hashim Thaçit mandatin për dy vjet e gjysmë. Nuk doli kështu. Tash jemi në prag të vitit 2014, në një vit në të cilin edhe ashtu afati ligjor është që të mbahen zgjedhjet e rregullta nacionale.

Atëherë duhet ta shtrojmë pyetjen: Ku ishte qëllimi i vërtetë i kësaj reforme? Është fare e qartë, Thaçi, Mustafa dhe Pacolli u morën vesh që të mos merreshin vesh. Dhe, kjo u pa gjatë punës së komisionit, i cili u krijua posaçërisht për reformën zgjedhore.

Lëvizja “Vetëvendosje” i ka parashtruar me kohë të gjitha idetë e saj dhe zgjedhjet apo pozicionimet i ka pasur të gatshme menjëherë gjatë muajve të parë të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore.

Prandaj, duhet të thuhet hapur që kjo reforma zgjedhore me të vërtetë është mbajtur peng prej aktorëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të grupit, edhe dy minuta.

GLAUK KONJUFCA: ...në anën tjetër, këto kohët e fundit jemi bërë dëshmitarë të një dukurie politike të pakëndshme. Sa herë që faktorët ndërkombëtarë duan që reforma zgjedhore të zhblllokohet, zyrat e jashtme i thërrasin krerët tanë politikë në disa takime të mbyllura. U bëjnë trysni atyre dhe kështu po ecën zvarrë procesi i reformave zgjedhore.

Gjithsesi, unë mendoj që një praktikë e tillë nuk është duke i bërë nder askujt. Së pari, nuk u bën nder faktorëve ndërkombëtarë, sepse vlerat që duam t'i zhvillojmë në Kosovë janë integriteti institucional dhe demokracia e lirë, e jo trysnia dhe paternalizmi. Por, kjo nuk i bën nder as Kosovës, sepse kështu na portretizon si një shtet, i cili udhëhiqet nga një garniturë politike që nuk funksionon ndryshe, përveçse nëpërmjet politikës së veshëve të tërhequr.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj ta përshëndes vendimin e Qeverisë së Kosovës për heqjen e taksës së sigurimit të veturave për qytetarët e Luginës së Preshevës. Kjo taksë për shqiptarët e Luginës së Preshevës u bë barrierë financiare për izolimin dhe mbylljen e tyre.

Në këtë Kuvend, nga shumica e deputetëve, sidomos të Anamoravës, është kërkuar heqja e kësaj takse. Deputeti Lutfi Haziri e pati iniciuar debatin këtu, kur u votua një rezolutë, të cilën Qeveria e zbatoi në prag të fushatës zgjedhore për pushtet komunal.

Më 11 tetor 2013, u mor vendimi nga Qeveria për heqjen e saj, me të cilën lirohen nga pagesa e sigurimit veturat e pronarëve privat të asaj ane, por nuk lirohen automjetet e regjistruara në emër të bizneseve të tyre. Tash veturat lejohen të futen në Kosovë me të njëjtën dëshmi të mëhershme të pagesës, por pagesa nuk bëhet fare, sepse këtu shkruan se personi që e ka këtë polisë, i ka paguar 40 euro për dy javë, por në të vërtetë ato nuk i ka paguar. Kjo është një dëshmi e tillë.

Ndërsa dëshmia e vjetër që është paguar, është kjo tjetra. Këto realisht janë dy dëshmi identike, por njëra thotë se njëra është paguar nga pronari që është futur në Kosovë, ndërsa tjetra nuk është paguar fare. Këtu kemi të bëjmë me një falsifikim ndoshta të dokumenteve me dëshmi të rrejshme, të cilat i dënon ligji, prandaj duhet të sqarohet decidivisht se cila është baza ligjore e lëshimit të dokumenteve të tilla.

Qeveria e Kosovës ka bërë mirë që e ka hequr për qytetarët e Luginës së Preshevës këtë taksë, mirëpo zgjidhja më e pranueshme do të ishte sikur Qeveria t'i kompensojë dhe t'i lirojë nga pagesa njerëzit e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, kur atyre u ndodhin aksidentet në Kosovë.

Po ashtu, kjo domethënë se qytetarët e asaj ane nuk janë liruar nga pagesa, por Qeveria e Kosovës i kompenzon ata me paratë e taksapaguesve të Kosovës, të cilët kanë kërkuar që ata të paguajnë për njerëzit atje.

Pagesa me çmimin prej 40 eurove, sigurim dyjavor, që aktualisht po bëhet për çudi për çdo hyrje, nuk mban erë të mirë, sepse shtrohet pyetja pse kjo pagesë nuk bëhet siç ka qenë 20 euro për një javë, për një sigurim njëjavor? Dhe, pastaj lind natyrshëm dilema, a mos është rritur hisja ndaj kompanive të sigurimeve, nga e cila Qeveria do që t'i shpërblejë ata?

Pastaj, pse të mos lirohen nga pagesat edhe bizneset, kur dihet se e ardhmja e Luginës së Preshevës varet nga fuqia ekonomike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Poštovani predsedniče!

Uvaženi predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Izuzetno mi je velika čast da u svoje lično ime, ali i u ime Bošnjačke zajednice koja živi na teritoriji Kosova, čestitam borcu za ljudska prava Hilmjeta Apuk iz Mitrovice na historijskoj nagradi koju je dobila od strane Ujedinjenih Nacija.

Njen dugo godišnji rad, njena energija, upornost, pozitivizam koga prenosi na sve nas, a posebno na osnove sa umanjnim psiho-fizičkim sposobnostima, rezultirala je njen decenijski rad na terenu, kako na lokalnom, tako i na centralnom nivou. Nagradu koju je dobila uvažena Hilmijeta Apuk je velika čast za Bošnjačku zajednicu, ali i za sve nas građane Republike Kosova, i ja još jednom čestitam i želim puno uspeha u daljem radu. Zahvaljujem!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Saša Đokić.

SAŠA ĐOKIĆ: Zahvaljujem se gospodine predsedniče!

Govorim u ime Poslaničkog kluba "Zajednička Budućnost". Želim da pokrenem jedno pitanje koja je bila i na Skupštinskom odboru za zdravstvo, rad i socijalno.

S obzirom ne vidim predstavnike Vlade, i upućujem kritiku ministrima, pokrećem pitanje za gospodina ministra Zdravlja. S obzirom da u opštinama koja su decilizovane, distribuju se lekovi i medicinska sredstva koja se prvo skladište nenamenski bez određenih certifikata, i postoji osnovna sumnja da se ta medicinska sredstva i medikamenti zloupotrebljavaju od Departmana za zdravstvo u decilizovanim opštinama.

Ja pozivam ministra za Zdravlje da uputi nadležne organe, odnosno inspekciji da se ispita šta je sa tim sredstvima koja Vlada, odnosno Ministarstvo zdravlja daje na upotrebu ambulantama i bolnicama.

Ukoliko ministar ne udovolji ovom našem zahtevu, mi tražimo, gospodine predsedniče od vas, da iskoristite sva vaša prava i uticaj zakonski Republike Kosova da se to ispita i da se podnese izveštaj šta je s tim.

Napominjem, mi smo to pokrenuli na Odboru za zdravstvo. Ja nažalost nisam bio prisutan, i ponavljam zahtevam od ministra da formira i pošalje inspekcije u ovim opštinama gde postoji osnovna sumnja da se sredstva zloupotrebljavaju. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, kryetar!

E nderuara zonja zëvendëskryeministre,

Të nderuar deputetë,

Më 9 dhjetor 2013, Banka Qendrore e Kosovës ka arritur të pajisjet me ‘swift kod’. Kjo është si dëshmi e frymës së re të qeverisjes në Bankën Qendrore. Ky kod ndërkombëtar i mundëson shtetit të Kosovës që institucionet financiare që operojnë në Kosovë, tani e tutje do të identifikohen si institucionet e Republikës së Kosovës në sistemin, i cili gjithashtu është një faktor shtesë në forcimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës. ‘Swift kodi’ për Kosovën ka disa elemente të rëndësishme që reflektojnë në planet ekonomike strategjike dhe një ndër to është edhe avancimi i imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Lidhje me ‘swift kod’ është një hap shumë i rëndësishëm për Kosovën, pasi tani e tutje bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës do të mund të pranojnë dhe të dërgojnë informacione të ndërlidhura me transaksionet financiare në një mjedis të tregut, si dhe do të krijohen lehtësime për transaksionet financiare ndërkombëtare me rastin e qasjes në tregjet financiare në nivelin ndërkombëtar, ku institucionet financiare të Kosovës do të identifikohen me kod të veçantë.

Implementimi i ‘swift kodit’ do të mundësojë avancimin e sistemit të bankave komerciale që operojnë në Kosovë, duke ngritur efikasitetin e tansfereve ndërkombëtare, rritjen e sigurisë së informacioneve financiare në sistemin e pagesave ndërkombëtare. ‘Swift kodi’ është përfitim i madh për shtetin e Kosovës, meqë reflekton pozitivisht te komuniteti i biznesit vendor dhe atij ndërkombëtar nëpërmjet ekzekutimit më të shpejtë të pagesave, uljes së kostos në kryerjen e pagesave në transferet ndërkombëtare, sigurimit të një midisi të shëndoshë sa i përket sistemit të pagesave për transaksionet financiare.

Të gjitha këto lehtësira do të arrihen, pasi transferet financiare nuk do të kalojnë nëpërmjet bankave ndërmjetësuese në nivelin ndërkombëtar, ashtu siç kanë vepruar deri me tani. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderuara zëvendëskryeministre,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Për shkak se ne deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk kemi ndonjë informatë zyrtare për rrjedhat e negociatave ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë, që po zhvillohen në Bruksel, në të cilat po diskutohet dhe sigurisht po vendoset mbi transformimin e pjesëtarëve të MUP-it serb në Policinë e Kosovës, andaj si deputet i Kosovës për këto çështje kaq të rëndësishme po informohem, ashtu sikur edhe qytetarët e

tjerë të Kosovës, nëpërmjet medieve, nga të cilat bëhet e ditur se së shpejti në Policinë e Kosovës do të inkuadrohen mbi 300 pjesëtarë të MUP-it serb.

Më e keqja e këtij veprimi është se inkuadrimi i këtyre pjesëtarëve të MUP-it të Serbisë në Policinë e Kosovës do të bëhet pa kurrfarë verifikimi, e madje do të inkuadrohen edhe ata policë që nuk e kalojnë verifikimin e bërë nga AKI-ja, që shikuar realisht, në Policinë e Kosovës do të mund të inkuadrohen edhe ata që kanë kryer krime të ndryshme gjatë luftës në Kosovë, edhe ata që kanë vepruar, veprojnë dhe do të veprojnë me tërë qenien e tyre kundër shtetit të Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Mendoj se një vendim i këtillë dhe një qëndrim humbës i Qeverisë së Kosovës, duhet pranuar listën e pjesëtarëve të MUP-it, me një insistim të vetëm, që këta policë të trajtohen dhe të shkollohen në Policinë e Vushtrrisë, është i papranueshëm, jo vetëm për ne deputetëve të Kuvendit, por edhe për popullatën shumicë të Kosovës.

Është i padrejtë, sepse në Policinë e Kosovës po inkuadrohen pa konkurs dhe pa përzgjedhjen e rëndomtë edhe ata persona që, sipas të gjitha gjasave, ndoshta edhe kanë kryer krime të ndryshme në Kosovë. Po pranohen edhe ata që në vazhdimësi punojnë kundër shtetit dhe popullatës të Kosovës, e në anën tjetër do të paguhën nga Buxheti i Kosovës, i cili sigurohet nga taksat dhe paratë e qytetarëve të saj.

Andaj, kërkojmë nga Qeveria jonë që pavarësisht nga presionet e faktorit ndërkombëtar të vihet në anën e popullit dhe t'i mbrojë interesat e tij, duke insistuar dhe këmbëngulur që pjesëtarët e Policisë së komunitetit serb, të cilët do të inkuadrohen në Policinë e Kosovës të përzgjidhen me konkurs pas verifikimit nga AKI-ja dhe gjithsesi të jenë nga radhët e komunitetit serb që jetojnë në Kosovë, e jo në Serbi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetari i Grupit, Visar Ymeri

Siç e dini, më 14 mars të këtij viti, me iniciativën e Lëvizjes “Vetëvendosje” u soll në Kuvend Projektligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personat e dhunuar gjatë luftës, viktimave civile dhe familjarët e tyre, ku edhe e mori përkrahjen e shumicës së deputetëve për të kaluar në shqyrtim të parë.

Ky projektligj, sipas Rregullores, i ka kaluar të gjitha komisionet funksionale, është organizuar një dëgjim publik dhe janë pranuar amendamentet e propozuara nga deputetët.

Procedimi i këtij projektligji i ka kaluar të gjitha afatet ligjore, meqë sipas nenit 57 paragrafi 6 të Rregullores së Kuvendit thuhet që Komisioni Funkcional ia paraqet Kuvendit raportin me rekomandime për projektligjin brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë.

Dhe, në rastin tjetër, paragrafi 7, i po të njëjtit nen, sipas të cilit në raste të veçanta komisioni mund të kërkojë nga Kuvendi afat shtesë deri në një muaj për ta paraqitur raportin.

Komisioni Funkcional për Shëndetësi e ka shfrytëzuar të drejtën e afatit shtesë, duke përfshirë në këtë projektligj disa propozime të dhëna na Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe disa propozime nga Shoqata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mirëpo, edhe pas këtij afati shtesë ky projektligj po vonohet që të sillet në Kuvend për shkak të kryetares së Komisionit për Komunitete dhe Kthim, zonjës Jasmina Zhivković, e cila e ka bllokuar procedimin e tij me arsyetimin që në këtë projektligj përmendet lufta çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër forcave serbe.

Ne kërkojmë dhe insistojmë që ky projektligj të procedohet menjëherë në Kuvend, sepse një komision nuk mund të dalë mbi Kuvendin dhe deputetja në fjalë nuk ka as mandat kushtetues, e as ligjor që ta bllokojë një projektligj tashmë të votuar nga Kuvendi në lexim të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Miratimi i Ligjit për personat e verbër nga Kuvendi i Kosovës, në vitin e kaluar ishte shpresë se do të ndryshojë shumë gjëra në favor të kësaj kategorie, sepse siguron kompensim, integrim, punësim, arsimim dhe përfitime tjera për personat e verbër në Republikën e Kosovës.

Ky ligj ka hyrë në fuqi më 2 korrik të vitit 2012, ndërsa është dashur të zbatohet në janar të vitit 2013.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ishte e obliguar me ligj që ta formonte Komisionin mediko-social, i cili është formuar me vonesë, e jo në afatin e paraparë me ligj. Sipas Shoqatës së të Verbërve, deri më tani kanë aplikuar 1 880 veta, janë ekzaminuar 680 nga komisioni mediko-social dhe janë në pritje edhe 1 200 për t'u ekzaminuar.

Kompensimi në vlerë prej 100 euro për efekt verbërie nuk ka ndodhur ende. Me rishikim të buxhetit për këtë kategori janë ndarë 1 400 000 euro në vijë të veçantë buxhetore për vitin 2013.

Deklaratat e ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale, të datës 5 dhjetor në KTV, se personat e verbër janë diku nga 3 000 deri në 8 000 veta dhe se kanë aplikuar 7 000 persona kanë filluar të ngjallin dyshime dhe mosbesim te kjo kategori se diçka nuk është në rregull, sepse kompensimi material për efekt verbërie nuk është duke ndodhur.

Për të mos pasur dilema, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kërkoj që të fillojë ta zbatojë ligjin dhe të fillojë menjëherë kompensimin e personave të verbër me kompensim material për efekt verbërie, pasi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me rishikim të buxhetit, është ndarë buxheti dhe kompensimi t'u bëhet në mënyrë retroaktive të gjithë përfituesve, sipas kriterëve të parapara me ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: I nderuar kryetar!

E nderuara zëvendëskryeministre,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Ka një javë që e kam pritur këtë fjalë. Nëse kemi dallime në vlerësime gjatë mandatit të institucioneve të shtetit për nivelin e përgjegjësive, të gjithë pajtohemi se në ditën e zgjedhjeve, shteti juridik, autoritetet politike dhe ndërgjegjja qytetare ishin në nivel të plotë, por edhe mesazhi i këtyre zgjedhjeve ishte i plotë dhe i drejtpërdrejtë.

Nëse djali i një kryetari të Komunës kërcënon dhe shantazhon një qytetar dhe nëse djali i një qeveritari apo i një ligjvënësi e sulmon një zyrtar, doemos do të ndëshkohen prindërit e tyre. Nëse jo ndryshe, me fuqinë e votës të qytetarëve. Së bashku edhe formacionet politike të prindërve të tyre do të ndëshkohen.

Gjithashtu, kur sulmohen autoritetet shtetërore nga qytetari me revole si në filma, në mes dite dhe në prani të publikut, ndërsa prokurori dhe Policia heshtin për motive të qarta të konsumimit të veprës penale, duke e zhdukur shtetin juridik dhe veprimin kompetent policor, natyrisht se edhe qytetarët ditën e bekuar të tyre do të preferojnë protagonistë të tjerë për sigurinë e tyre në drejtimin e institucioneve.

Kur qytetarët e shohin që pasuria e zyrtarëve po zgjerohet më shumë se që mund të bëjnë me të ardhurat e tyre të rregullta dhe në këto raste nuk shohin institucionet e shtetit duke kërkuar llogari, natyrisht që në ditën e bekuar të tyre do të ndëshkojnë.

Shteti juridik nuk do të duhej të ishte nocion abstrakt as dekor ilustrativ në patetikën tonë, por do të duhej të prekej dhe të shihej çdo ditë nga qytetarët dhe kjo të mos bëhet për hir të votave, por për hir aspiratave të të gjallëve dhe të atyre që nuk janë më. Për hir të përgjegjësisë që e kemi. Kur të zgjedhurit e qytetarëve nuk e realizojnë këtë, natyrisht se në ditën e bekuar të qytetarëve ata do t'i ndëshkojnë të zgjedhurit e mëparshëm dhe do të provojnë protagonistë të tjerë.

Ky është mesazhi i këtyre zgjedhjeve. Kush e akcepton drejt këtë mesazh, do të jetë në nivelin e detyrave dhe nuk do të pësojë zhgënjime të radhës. Deri në këto zgjedhje, zyrtarët që e përvetësonin pronën shoqërore dhe vjedhin paranë publike quheshin të shkathtë, ndërsa zyrtarët parimorë perceptoheshin naivë.

Këto zgjedhje e shpalosen një vlerë të shoqërisë sonë dhe një dukuri të deritashme - zyrtarin abuziv edhe po ta mbështjellim me miliona, nuk e tundojmë qytetarin, sepse është bërë dyshues, jo në premtimin e dëshirueshëm, por në shprehitë e kandidatit se ato para më shumë do t'i gëzoj kandidati me rrethin e tij po të zgjidhet kryetar, sesa qytetarët të cilëve edhe u premtohet.

Këto zgjedhje kanë dhënë edhe mesazhe të tjera dhe kanë hapur kapituj të shumtë për zhvillimin e vendit tonë. Në rastet tjera, unë do t'i shpalos ato dhe do t'i nënvizoj, por ngaqë dëshira ime ishte që këtë fjalë ta kisha në seancën e kaluar, nuk kam inspirim dhe motiv më tepër që të zgjerohem. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë do të ngre një çështje, e cila ka të bëjë pikërisht me planin operativ, njëkohësisht me strategjinë, të cilën e ka hartuar Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me disa ministri relevante, e kjo strategji ka të bëjë me parandalimin e luftimit të etheve hemorragjike, me të cilën, më 26.6.2013, nga Komisioni për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mjedis është ftuar ministri i Shëndetësisë, zoti Agani, i cili është zotuar se strategjia për parandalimin e etheve hemorragjike është e gatshme dhe sipas fjalëve të tij ka mbetur që kjo strategji ta marrë miratimin në shtator gjatë këtij viti nga Qeveria dhe njëkohësisht të sillet në Parlamentin e Kosovës.

Tash jemi në dhjetor dhe nuk ndodhi që kjo strategji ta marrë këtë miratim në Qeveri dhe, si duket, edhe qytetarët e Malishevës, por edhe të komunave përreth edhe gjatë vitit 2014 do të ballafaqohen me problemin e tillë, me të cilin gjatë vitit 2013 kanë pësuar me vdekje fatale, e vetëm nga komuna e Malishevës kanë vdekur 6 qytetarë, ndërsa në komunat përreth saj numri që kanë vdekur është 9 qytetarë.

Unë kërkoj nga ministri, i cili sot nuk është i pranishëm, që urgjentisht ta sjellë strategjinë dhe ta marrë miratimin nga Qeveria dhe njëkohësisht strategjia e tillë të sillet edhe në Parlament, sepse në bazë që ne e kemi, kostoja e implementimit për këtë strategji kushton 1,8 milion euro dhe kur është në pyetje vdekja apo siguria e qytetarëve të vendit, nuk janë në pyetje paratë publike, prandaj kërkoj që sa më shpejt kjo strategji ta marrë këtë miratim dhe njëkohësisht që gjatë vitit 2014 të formohen grupet dhe komisionet në bazë të planit operativ dhe njëkohësisht të implementohen objektivat për parandalimin e etheve hemorragjike edhe për komunën e Malishevës, por njëkohësisht edhe për komunat përreth.

Prandaj, edhe një herë i bëj thirrje ministrit Agani që sa më shpejt këtë strategji ta sjellë edhe në Qeveri, njëkohësisht edhe në Parlament. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, e kemi shteruar kohën e nevojshme për këtë pikë të rendit të ditës. Radhën e ka, sipas kërkesës së saj, zëvendëskryeministrja e Kosovës, zonja Edita Tahiri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Më lejon t'i jap disa informacione lidhur me pyetjen që erdhi nga deputeti Demolli, e që ka të bëjë me Marrëveshjen e Brukselit dhe unë në veçanti do të ndalem te çështja e sigurisë dhe t'ju them se sipas Marrëveshjes së Brukselit, çështja e sigurisë shkon në dy drejtime, në kuptimin e zgjidhjes.

Drejtimi i parë është zhbërja e plotë e strukturave ilegale serbe të sigurisë që kanë vepruar në pjesën veriore të vendit tonë që nga përfundimi i luftës dhe këto struktura i përbëjnë jo vetëm zyrat e ish-MUP-it, por edhe e ashtuquajtura Mbrojtja Civile, që për mendimin tonë është një strukturë paramilitare, e cila po ashtu duhet të shuhet plotësisht, si dhe të gjitha strukturat tjera të mekanizmave serbë të inteligjencës, të cilat duhet të shuhen.

Paralelisht me këtë proces, është edhe procesi i integritetit të individëve serbë, të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e institucioneve të sigurisë të Kosovës, përkatësisht Policisë së Kosovës. Dhe, të jem tani konkrete sa u përket procedurave të integritetit, ato bëhen sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, duke u nisur nga konkursi, i cili do të jetë për këtë çështje, pastaj procedurat e verifikimit, të cilat do të bëhen nga Policia e Kosovës me ndihmën e EULEX-it, por edhe mekanizmat tjerë që i ka shteti i Kosovës për çështjet e verifikimit.

Në kuadër të kriterëve sigurisht janë trajnimet, është plotësimi i kushteve që kërkohen, pra kushtet profesionalo-teknike, por edhe integriteti moral i individëve. Mirëpo, ju nuk duhet të harroni, por as ne të gjithë, që ne tashmë e kemi miratuar Ligjin për amnistinë dhe, sipas tij, në fakt, ne i kemi dhënë mesazhet e qarta që jemi të gatshëm për integrimin e qytetarëve serbë të pjesës veriore në institucionet e shtetit të Kosovës, mirëpo ky ligj natyrisht nuk i përfshin ata të cilët kanë histori kriminale, prandaj edhe individët që janë të interesuar të përfshihen në Policinë e Kosovës, në qoftë se kanë histori kriminale, nuk mund të jenë pjesë e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demolli e kërkoi fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryesues!

Unë në të vërtetë nuk shtrova pyetje, por vetëm e ngreha një çështje, sepse në bazë të informatave që i kemi, për këta pjesëtarë të policisë, të cilët do të inkuadrohen në radhët e Policisë kosovare, nuk do të bëhet verifikimi i tyre fare nga organet kompetente.

Mirëpo, unë e falënderoj zëvendëskryeministren edhe ishalla qëndron dhe do të qëndrojë edhe në të ardhmen prapa fjalëve të saj se këta pjesëtarë të Policisë do të verifikohen dhe do të eliminohen kuptohet nga inkuadrimi i tyre ata persona, të cilët do ta kenë një biografi, apo do ta kenë një të kaluar kriminale.

E sa i përket Ligjit për amnisti, e tha edhe vetë zëvendëskryeministrja, amnistohen ata të cilët nuk kanë kryer vrasje, ata të cilët nuk kanë kryer krime të rënda, mirëpo nuk do të thotë se në qoftë se amnistohen ne do t'i pranojmë duar hapur në institucionet tona shumë të ndjeshme, siç është Policia, Gjykata, Prokuroria dhe Agjencia për Inteligjencë Kosovare. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Tahiri e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar deputet,

Unë e kisha parasysh që nuk ishte pyetje parlamentare, por e vlerësova që ishte moment i mirë që të ndajmë informacionin së bashku dhe unë dëshiroj edhe njëherë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës t'ju siguroj, që jo vetëm se do të ketë verifikim, do

të ketë konkurs, verifikim, plotësim kriteresh me dokumentacion të verifikuar, trajnim, ashtu siç bëhet për çdo individ që dëshiron të bëhet pjesë e Policisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë të parashtruara 13 pyetje. Disa nga ministrat nuk janë këtu, megjithatë, unë sipas Rregullores do t'ju thërras një nga një. Pyetja e parë është e zonjës Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Ferid Agani. Dëshiron ta bësh pyetjen, Ganimete?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje për të gjithë deputetët!

Unë e kam parashtruar këtë pyetje edhe për seancën e kaluar, ka munguar ministri, mungon edhe në këtë seancë. Prapëseprapë nuk do ta parashtoj pyetjen, megjithëse qytetarët e edhe unë personalisht kisha dashur të marr një përgjigje të drejtpërdrejtë prej ministrit. Shpresoj që ministrat në të ardhmen të jenë pak më të përgjegjshëm kur ka pyetje parlamentare, sepse është obligim i tyre që të përgjigjen para deputetëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Fehmi Mujota, por ajo nuk është e pranishme.

Zoti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Kuçi. A dëshironi ta bëni pyetjen zoti Visar edhe pse ministri s'është këtu?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe kjo pyetje është e bartur nga seanca e kaluar kur ka munguar ministri i Drejtësisë, zoti Hajredin Kuçi, që po mungon edhe sot. Pra, e kam lexuar edhe herën e kaluar, vetëm po e përmbledh- pyetja ka të bëjë me një vendim të Gjykatës Komonale në Besianë lidhur me një pronë të Adem Jasharit si kreditor, i cili është bërë i plotfuqishëm pas ankesës së debitorëve Sahit, Rexhep dhe Fatbardh Demiri, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Ky vendim nuk është zbatuar ende dhe pyetja ime ka pasur të bëjë me arsyet, domethënë për t'i marrë arsyet nga ministri, se përse nuk po zbatohet ky vendim dhe pse Gjykata Themelore në Besianë nuk po vepron me ngutshmëri në këtë çështje, kur dihet që legjislacioni në fuqi e detyron për një veprim të tillë?

Kjo është hera e dytë që po e shtroj pyetjen dhe nuk kemi përgjigje nga ministri. Shpresoj, dhe në insistoј në fakt, që këtë përgjigje ta kemi nga ministri, nëse jo kështu në seancë, atëherë me shkrim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa, pyetje për ministrin Buja. Ministri s'është këtu. Zoti Mustafa, e keni fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Unë do ta bëj pyetjen që ka të bëjë me Buxhetin e dedikuar për universitetet e reja publike. Ministri Buja më tha se e ka përgatitur një përgjigje, por i duhet të shkojë në Selanik. Qenka këtu ministri i Financave, nëse ka informata edhe përgjigja e tij do të ishte me vlerë.

I nderuar zoti ministër,

Luteni që të jepni sqarime lidhur me buxhetin për universitetet e reja publike: Pejë, Mitrovicë, Gjilan e Gjakovë. Sa është buxheti për këto universitete, pasi që rritja e buxhetit për arsim sivjet nuk jep hapësirë edhe për një financim të tyre minimal? Ose nëse financimi i tyre bazohet në ndonjë ristrukturim brenda buxhetit për ministri, ku janë bërë shkurtimet për këtë dhe ristrukturimet eventuale brenda buxhetit të Ministrisë?

KRYESUESI: Në rregull. Ministri nuk e ka pasur pyetjen dhe ka të drejtë që të mos përgjigjet.

Sërish deputeti Muhamet Mustafa, pyetje për ministrin Mujota, e keni pyetjen e dytë. Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Unë këtë pyetje e pata bërë edhe kur diskutuam për projektin e buxhetit dhe u pata dërguar edhe me shkrim ministrave, por si duket nuk pat hapësirë të jepet përgjigje në atë seancë, prandaj jam drejtuar sipas Rregullores.

Pyetja ka të bëjë me projektin e Autostradës Prishtinë-Shkup.

I nderuar zoti ministër,

Luteni që të sqaroni se sa është norma, përkatësisht përqindja e kthimit të investimeve nga projekti i Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit? Kjo përqindje shpreh në mënyrë sintetike përfitimet ekonomike e sociale nga ky projekt. Kjo nuk është prezantuar në buxhet nën tekstin përcjellës, pastaj përveç kësaj nuk shihet edhe se si mendohet të përmbillet konstrukti i financimit, pasi nga buxheti për tri vjetët e ardhshme janë paraparë 300 milionë, derisa kostoja e këtij projekti parashihet të jetë mbi 600 milionë euro?

Duket se nga kjo që kemi në buxhet po hyjmë në një situatë të panjohur dhe të pasigurt, të paverifikuar, por ndoshta përgjigja e ministrit na i sqaron këtë çështje.

KRYESUESI: Zoti ministër Mujota, e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Mustafa,

Segmenti rrugor Prishtinë - Hani i Elezit, ka rëndësi të veçantë ekonomike për Kosovën dhe rajonin, duke integruar kryeqytetet e rajonit dhe qendrat ekonomike në rrjetin rajonal të transportit.

Ministria e Infrastrukturës, pas vendimit të Qeverisë për krijimin e Komitetit Drejtues Ndërmintor për Autostradën R-6, segmenti Prishtinë - Hani i Elezit, i ka kryer përgatitjet e nevojshme për realizimin e këtij projekti strategjik.

Në bazë të rekomandimeve nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, është formuar Komisioni për plotësimin e studimit të ndikimit ekonomik dhe social për ndërtimin e autostradës R-6. Ky komision në muajin shkurt të këtij viti ka dorëzuar raportin final, i cili është aprovuar nga Banka Botërore.

Studimi i ndikimit ekonomik dhe social për ndërtimin e autostradës bazohej në një vlerësim të mëparshëm ekonomik të Autostradës, Rruga 6, Prishtinë - Hani i Elezit, e bërë nga Kompania EGIS - International në vitin 2011. Vlerësimi i realizueshmërisë ekonomike ka përllogaritur normë kthimi të brendshme ekonomike prej 10,6% gjatë 25 vjetëve të periudhës së analizës dhe një vlerë aktuale neto të kostove dhe përfitimeve ekonomike prej 130 milionë eurosh, duke pasur parasysh një normë zbritje prej 9%. Vlerësimi i realizueshmërisë ekonomike dhe përfitimeve të mëposhtme ekonomike të projektit është si vijon:

- Kostot ekonomike të ndërtimit;
- Kostot ekonomike të operimit dhe mirëmbajtjes së Rrugës 6; si dhe
- Kursimet ekonomike dhe kostot e mirëmbajtjes në Rrugën ekzistuese paralele ND.
- Kostot e reduktuara të operimit të automjeteve;
- Numrin e reduktuar të aksidenteve;
- Kursimin e kostove të udhëtimit dhe vlerën e kohës si dhe
- Gjenerimin e punësimit.

Plani i zbatimit të Rrugës 6, Prishtinë - Hani i Elezit varet nga procedurat e mëtutjeshme dhe përfundimi i procedurave tenderuese në bazë të projeksioneve të deritanishme, të cilat janë në përputhje të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.

Afati kohor i realizimit të punimeve planifikohet në përputhje të plotë me buxhetin e alokuar vjetor, për ndërtimin e kësaj autostrade, pa cenuar stabilitetin financiar të vendit.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Unë e falënderoj ministrin për këtë përgjigje.

Do të kisha dashur që këto të dhëna t'i kemi me buxhetin dhe të kemi një informatë, sepse ky është projekt me rëndësi nacionale dhe deputetët dhe qytetarët duhet të jenë të interesuar.

Përqindja e kthimit për 20 vjet nuk është adekuate. Është afër pragut minimal për projektet e Bankës Botërore. 130 milionë euro vlerë neto do të thonë diçka, por ky kthim nuk është vënë në raport me mundësinë e investimit të mjeteve me projekte të tjera, ku eventualisht kjo normë e brendshme e kthimit do të ishte më e lartë.

Sa i përket përmbylljes së konstruktit të financimit, prapë nuk jam i kënaqur me përgjigjen. Unë kërkoj nga Ministria që të kërkojë burime alternative të financimit dhe këtë projekt mos ta përqendrojë vetëm në mjete buxhetore, sepse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Mujota e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar deputet Mustafa!

Unë vetëm prezantova të dhënat e nxjerra nga ekipet profesionale dhe kompanitë e kualifikuara për këtë gjë dhe besoj se do të jetë në përputhshmëri të plotë edhe me standardet dhe në funksion që do të ketë autostrada.

Ndërsa çështja e planifikimit për Rrugën 6, tashmë jemi në procedurë të vlerësimit financiar. Ende nuk kemi ardhur tek vendimi përfundimtar për kontratën, shpresoj që shumë shpejt do ta kemi këtë kontratë, e cila do të jetë në përputhje të plotë me mundësitë buxhetore të vendit, po e përsëris edhe njëherë, pa cenuar stabilitetin financiar. Dhe, afati i realizueshmërisë së projektit Prishtinë – Hani i Elezit është paraparë të jetë 42 muaj, që do të jetë një afat optimal për realizim efikas të këtij projekti.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Kadrijaj, pyetje për ministrin Çeku. Ministri s'është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Pyetja ka qenë kështu.

Qe një kohë të gjatë është formuar Komisioni Qeveritar për Verifikimin e Dëshmorëve të Kombit, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës. Procesi i aplikimit ka kohë që ka përfunduar. Dhe, pyetja i është dedikuar ministrit se deri ku kanë shkuar procedurat e verifikimit, sepse dihet se kemi një numër shumë të madh të veteranëve, të cilët nuk janë përfshirë në Ligjin për kategoritë e luftës dhe janë në një gjendje të rëndë ekonomike.

KRYESUESI: Prapë zonja Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani. Ministri s'është këtu.

TIME KADRIJAJ: Po e parashtrojmë pyetjen.

Një kohë të gjatë, shumë të gjatë, besa disa vjet në Qendrën Klinike Universitare ka mbetur pa drejtorë të qendrave klinike universitare. Dhe, puna në këto njësi dhe në këto reparte është zhvilluar me ushtrues të detyrave prej vitit 2010.

Tash konkursi është hapur për drejtorë të klinikave, por pyetja ka qenë se a është hapur sipas kriterëve dhe sipas ligjeve në fuqi, sepse dy herë është hapur konkursi, janë zgjedhur drejtorët dhe është anuluar? Dhe, a janë formuar Shërbimi klinik spitalor dhe të gjitha organet tjera, sepse në bazë të Ligjit të shëndetësisë, fillimisht duhet të krijohet kjo njësi dhe më pas të hapet konkursi për drejtorë të klinikave. Dhe sipas statutit të Qendrës Klinike Universitare, drejtorët duhet të zgjidhen dhe të jenë me njësi akademike - profesorë, ndërsa në konkurs thuhet se duhet të punojnë me orar të plotë. Si është e mundur kjo kur profesorët dihet se punë primare e kanë Universitetin, ndërsa punë sekondare e kanë punën nëpër spitale?

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Alma Lama, pyetje për ministrin Besim Beqaj.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministri i Financave ka nënshkruar më 3 dhjetor një marrëveshje me zyrtarë të Fondit për Zhvillim të Arabisë Saudite, për financimin e rrugës Prishtinë - Mitrovicë. Bëhet fjalë për marrje hua. Shuma e huas është 16 milionë dollarë, kthimi i së cilës do të fillojë në gusht të vitit 2018 dhe do të përfundojë në shkurt të vitit 2033.

Pyetja ime për ministrin është kjo: Cili ka qenë vizioni dhe qëllimi i Qeverisë së Kosovës me marrjen e huas nga Arabia Saudite, për një shumë të tillë prej 16 milionë dollarësh, në një kohë kur Qeveria e Kosovës me paratë e taksapaguesve ka financuar projekte shumë më të mëdha, siç është Autostrada “Ibrahim Rugova”, e cila ka kushtuar rreth 1 miliard euro?

Po kështu, cili është interesi bankar i aplikuar në këtë rast në kthimin e huas?

KRYESUESI: Zoti Beqaj, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar kryesues, Kabinet qeveritar, E nderuara deputete, Të nderuar deputetë, Realizimi i shpenzimit të parasë publike bëhet nëpërmjet Ligjit bazë të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësitë. Aty përcaktohet se si duhet të përpilohet korniza afatmesme e shpenzimeve, strategjia e borxheve dhe Buxheti i Republikës së Kosovës.

Meqenëse parapërgatitjet për autostradën “Ibrahim Rugova” kanë ndodhur gjatë vitit 2009, kur nuk kemi pasur ligj për borxhe publike fare, Qeveria në KASH të vitit 2009 dhe 2010 nuk ka mundur të huazojë mjete për realizimin e prioriteteve qeveritare dhe kombëtare.

Shfrytëzoj rastin t’ju njoftoj që edhe paratë e huazuara janë paratë e taksapaguesve sipas legjislacionit në fuqi.

Në rastin e ftesës për të marrë pjesë në cilësinë e shtetit observues në mbledhje dhjetor 2011 - 2012 të Bankës Islamike për Zhvillim, Qeveria ka identifikuar dy projekte potenciale për të financuar nga portfolja e lejuar për Kosovën në Bankën për Investime.

Zgjerimi i rrugës Prishtinë - Vushtrri - Mitrovicë, me transitin rreth qytetit të Vushtrrisë, me studim të fizibilitetit është vlerësuar se do të nevojitet pjesëmarrja e disa institucioneve ndërkombëtare financiare me kushte të kredive zhvillimore për të mbuluar nevojën për të realizuar strategjinë multimodale të transportit, e cila është në harmoni edhe me zotimin e Qeverisë për përmirësim të Korridorit rajonal 6 – 7 deri në vitin 2018.

Marrëveshjet financiare për këtë rrugë janë njëherësh marrëveshjet e para që kemi filluar me Bankën Islamike për Zhvillim, Fondin e OPEK-ut, të dy këto marrëveshje tanimë janë ratifikuar në Kuvend, dhe Fondin për Zhvillim të Arabisë Saudite. Projekti për zgjerimin e magjistrales ka hyrë në mars të vitit 2012 në KASH për 2013 – 2015 dhe në strategjinë 2013 dhe 2014 të borxheve dhe si rezultat në vitin 2013, Qeveria ka filluar t’i përfundojë lotët 1 - 3, që kanë qenë të parapara të fillojnë në vitin 2013.

Financimi i jashtëm për këtë rrugë, pra siç e thatë edhe ju, në tërësi është 55 milionë, ndërsa për pjesën me Arabinë Saudite është 16 milionë dollarë dhe kamata është 2%. Pra, pse nuk është bërë atëherë, për shkak se nuk ka pasur ligj të borxheve shtetërore, në bazë të cilit ne kishim mundur të marrim hua të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Alma.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Zoti ministër,

Unë nuk ju pyeta as për ligjin dhe as për procedurat. Nuk i vura në diskutim procedurat dhe as për Autostradën “Ibrahim Rugova”, e cila ka kushtuar 1 miliard euro, një shumë marramendëse krahasuar me koston reale të tregut, pra ka pasur abuzim të jashtëzakonshëm, por ju pyeta për vizionin e marrjes hua nga Arabia Saudite. Dhe, arsyeja pse ju pyes për këtë është sepse Kosova është një vend i brishtë, ku nuk sundon ligji dhe Kosova është një vend, aktualisht i cili po rrezikohet nga ngritja e fundamentalizmit islamik. Dhe, ky lloj orientimi nuk duket ai i duhuri. Kosova duhet të ketë një orientim strategjik kombëtar dhe të lidhet më shumë me vendet e Perëndimit dhe jo të hap rrugë të dyshimta në të ardhmen.

Kam arsye të paragjykoj, duke pasur veçanërisht parasysh situatën pikërisht në Mitrovicë dhe duket pak...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Beqaj, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Për hir të korrektesisë ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe ndaj deputetëve, dua të them që shifra që ju po përmendni për Autostradën “Ibrahim Rugova” nuk është e saktë. Ajo shifër do të dihet këtyre ditëve dhe nuk i afrohet as 1 miliardi, dhe nuk do të jetë mbi një miliard. Prandaj, ju kisha lutur që informatat t’i keni të plota.

Ndërsa, sa u përket marrëdhënieve dhe vizionit, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe shteti i Kosovës ka vizion të bashkëpunimit për fondet zhvillimore. Ky shtet duhet të hapë rrugë për fonde zhvillimore. Dhe, fondeve zhvillimore, pse nuk po i referoheni që Kosova është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar, është anëtare me të drejta të plota në Bankën Botërore dhe shumë kredi ky Kuvend i ka miratuar. Është anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe para disa ditësh e kemi bërë edhe një marrëveshje me ta. Është anëtare e Bankës Evropiane për Investime, ku para disa ditësh për biznes kemi nënshkruar një kontratë 10 milionë eurosh për financimin e sektorit privat, me banka komerciale, pra për sektorin privat. Dhe, njëkohësisht tani së voni është anëtarësuar edhe në Bankën e Zhvillimit të Këshillit të Evropës.

Në kuadër të këtyre të gjitha angazhimeve, ne nuk dëshirojmë të jemi përjashtues për asnjë fond zhvillimor, i cili është fond i audituar dhe i njohur mirë ndërkombëtarisht.

Prandaj, nuk do të ishte mirë, që t’u jepen konotacione të tilla. Po e them që Qeveria e Kosovës para së gjithash ka reputacion të të gjitha institucionet financiare

ndërkombëtare, të cilat i përmenda dhe kemi hyrë në marrëdhënie kontraktuale me ta. Dhe, kjo është ajo e cila Kosovës i duhet dhe për këtë ne do të punojmë si Qeveri e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Lama, pyetje për kryeministrin Thaçi. Kryeministri s'është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zonjës Lama, fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Nëse më lejohej, dy fjalë për ministrin.

Natyrisht, fondet zhvillimore po, por nuk besoj se për 16 milionë euro ia vlen të futet Kosova 20 vjet në borxhe. Domethënë, nuk shoh se ka ndonjë logjikë këtu, përveç se dyshimit.

Pyetja në lidhje me kryeministrin e Kosovës: Më 6 qershor 2013, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Rezolutën për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Në pikën e parë të kësaj Rezolute thuhet: "Qeveria e Republikës së Kosovës të kushtëzojë marrëdhëniet me Serbinë me kujdesin dhe interesimin shtetëror për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë lidhur me të drejtat e tyre civile, politike dhe etnike".

Në pikën 3, Qeveria e Republikës së Kosovës ta hapë një zyrë në Prishtinë dhe Gjilan për qytetarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes dhe atyre të cilët janë shpërngulur nga atje, sipas normave ndërkombëtare. Që prej miratimi i kësaj rezolute ka pasur bisedime të vazhdueshme me Serbinë, si nga ana e kryeministrit dhe zëvendëskryeministrja Tahiri, si dhe disa marrëveshje janë arritur.

Pyetja për kryeministrin: Çfarë kushtëzimesh keni bërë ju deri tani ndaj Serbisë, në mënyrë që të përmirësohet gjendja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës? Pse nuk e keni hapur ende Zyrën në Prishtinë dhe Gjilan? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj e kërkoi fjalën, meqenëse ju e keqpërdorët mikrofonin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit!

Meqenëse, mu referua prapë, më duhet të jap edhe një përgjigje tjetër. Huazimet bëhen në bazë të ligjeve. Dhe, huazimet janë të kushtëzuara me rregullën fiskale të cilën e ka aprovuar ky Kuvend i Republikës së Kosovës.

Rregulla fiskale thotë: "nuk mund të ketë huazime më të mëdha, se sa 2% nga GDP-ja." Pra, flet për bilanc bankar dhe për deficit buxhetor. Pra, deficitin buxhetor në bazë vjetore nuk mund të jetë më shumë se 2% dhe ky deficit lidhet edhe me financime të jashtme.

Prandaj, ju kisha lutur, kur të flasim për gjëra të huazimeve, një janë ligjet, dhe pastaj janë strategjitë, pastaj është mundësia dhe kufizimet të cilat i kemi dhe atë mund të flasim pse nuk huazojmë 160 milionë, po 16 milionë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Pyetja ime ka të bëjë pikërisht me këtë temë, që tashmë u përfol. Pra, tash e dimë që autostrada që ka qenë e planifikuar të jetë Vërmicë - Merdar, e që është përfunduar në Besi, ka përfunduar, është përruruar pra segmenti i fundit i saj. A mund të na tregoni, zoti ministër, a keni ndonjë raport të detajuar për shpenzimet e këtij projekti dhe a do ta dorëzoni një raport të tillë në Kuvend?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Mujota e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Ymeri,

Ministria e Infrastrukturës e ka menaxhuar realizimin e projektit nacional më të madhin në vend Autostradën Vërmicë - Merdar, që lidh korridoret ndërkombëtare 8 dhe 10. Nga fillimi e deri në përfundim të projektit të ndërtimit të kësaj autostrade, punët kanë ecur jashtëzakonisht mirë dhe janë përfunduar para afatit një vit, për çka jemi të gjithë të kënaqur se tashmë e kemi në shfrytëzim gjithë rrugën që ka qenë e kontraktuar.

Kompania mbikëqyrëse HILL International ka përgatitur dhe dorëzuar për aprovim raportin final të gjitha punëve të kryera, gjetjet e auditimit dhe koston finale të projektit, sipas kontratës me Behtel&Enkën, të firmosur më 12 prill të vitit 2010.

Ky raport do të shqyrtohet dhe aprovohet nga ana e Komitetit Drejtues Ndërkombëtar, përkatësisht ndërministror për Rrugën 7, se është bërë e qartë për një rrugë të karakterit rajonal e pse jo ndërkombëtar.

Raporti është produkt i kompanisë mbikëqyrëse HILL International, sipas obligimeve ligjore, si dhe auditimit final që kjo kompani ka bërë për të gjitha segmentet e projektit Vërmicë - Besi.

Kontrata me 'Behtel&Enka' është menaxhuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe është brenda parametrave financiarë të alokuar me buxhetin e aprovuar nga Parlamenti. Kostoja e punëve në ndërtimin e Rrugës 7 është 790 milionë 772 mijë 651,53 euro, përkatësisht nën vlerën 120% të paraparë me kontratë.

Përfundimi i Rrugës 7 pas vetëm 44 muaj nga fillimi i projektit tregon se Qeveria e Kosovës, institucionet tjera qendrore dhe lokale kanë kapacitete të nevojshme për të menaxhuar me sukses projektet të përmasave dhe standardeve më të larta ndërkombëtare. Administrimi i tyre dhe puna ekipore e të gjitha institucioneve të përfshira në projekt, bëri që dorëzimi i projektit të bëhet një vit para afatit të planifikuar.

Rruga 7 është kontraktuar sipas principit "projekto - ndërto". Ky është një shpjegim i treguar shumë herë në këtë Kuvend. Rruga 7 është përfunduar pa asnjë dënim, edhe pse pati disa pengesa në procesin e shpronësimit, në procesin e dislokimit të instalimeve dhe

punëve të paparashikuara të cilat u kapërcyen falë bashkëpunimit dhe planifikimit profesional të ekipit drejtues të projektit.

Dhe, një përgjigje shtesë për këtë, që duhet ta keni rreth të gjitha çmimeve, duhet të kemi parasysh se të gjitha punët tjera shtesë kanë qenë obligim i Qeverisë sipas kontratës, që përfshin zhvendosjen e stabilimenteve elektrike, ndryshimin e akcizës së karburantit, furnizimin me material guror për ndërtim dhe çështje të tjera, kapin një shumë prej 33 milionë eurosh, që në finale, në përfundim raporti tregon se do të paguajë Qeveria 824 milionë e 240 mijë e 327,82 euro.

Ndërsa, çështja e shpronësimeve, që shpeshherë diskutohet në Kuvend, besoj se po adresohet në mënyrë jo të drejtë, shpronësimet nuk janë pjesë e kontratës. Shpronësimet nuk janë pjesë e çmimit të kontratës. Dhe, ne...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ymeri?

VISAR YMERY: Po, faleminderit kryesues!

Unë iu referova koston së projektit, jo shpronësimeve. Nuk i bëra bashkë këto të dyja, edhe pse të dyja janë shpenzime për autostradën. Pra, nuk është e çuditshme që duhet të flasim për të dyja.

Por, për këtë raport, a do të jetë ky raport publik, a do t'i dorëzohet Kuvendit, deputetëve, a do të publikohet si raport i mbikëqyrjes së punimeve në autostradë?

Dhe, ju thatë që kostoja e gjithëmbarshme e kontratës që po i afrohet 800 milionëshit nuk e ka kaluar 120%-shin e paraparë me kontratë, por kontrata origjinale ka qenë 659 milionë, apo jo? Pra, nëse ka qenë 659 milionë e i kemi paguar 800, atëherë e ka tejkaluar, është mbi 120%.

KRYESUESI: Zoti Mujota, e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Jo, pikërisht unë po u referohem të dhënave, të cilat dalin nga raporti zyrtar. Asnjë cent i shpenzuar në autostradë nuk është punë e paditur për buxhetin e vendit. Dihet saktësisht çdo shpenzim, prandaj raporti është i plotë.

Për informimin tuaj dhe të publikut, ne mund ta bëjmë këtë sa herë që të kërkojë Komisioni Parlamentar një raport të tillë. Unë besoj, se edhe ju jeni anëtar i këtij komisioni dhe mund ta bëni, ky është raporti final, i nxjerr me të gjitha shpenzimet për kontratën e përfunduar. Ndërsa, në interesimet tjera për çështjet, se sa është gjatësia e rrugës apo edhe elementet tjera të kësaj kontrate, unë me kënaqësi do t'ju kisha ofruar të dhëna inxhinierie në qoftë se premtim koha. Por, pasi që është pyetje parlamentare, është pak e vështirë kjo punë.

Gjatësia e autostradës është 78 km, 2 x 3,75 autostrada me korsidye, limiti i shpejtësisë është 130 km/orë, nënshkrimi i kontratës ka ndodhur më 12 prill 2010, përfundimi i ndërtimit më 26 nëntor 2013. Ka 11 kryqëzime, ka 128 rrugë individuale

lokale me gjatësi mbi 51 km, ka të gjitha 9 zonat e pagesave, ka 4 zonat e mirëmbajtjes, 4 zonat e shërbimit, numri i urave në autostradë është 15, gjatësia totale 3 334 metra. Ura më e gjatë në seksionin e 8-të prej 750 metrave, pastaj numri i mbikalimeve është 31 me gjatësi prej 1 432 metrash, numri i nënkalimeve 27 me gjatësi prej 1 190 metra, numri i trarëve të parapërgatitur është 544.

Pastaj gjermimi më i thellë është 108 m në seksionin 5, mbushja më e lartë është 24 metra në seksionin 5, 9 objektet të prodhimit janë të përgatitura në këtë pjesë të autostradës, që nënkuptojnë mbi 25,5 milionë orë pune nga punëtorët. Numri i zhvendosjes së përgjithshme të shërbimeve është, siç më poshtë:

- Kemi 83 pajisje elektronike,
- 14 linja të tensionit të lartë elektrik,
- 60 linja të furnizimit me ujë,
- 102 linja të ujërave të zeza, ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Fehmi Mujota. Deputete e keni fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Zoti ministër,

Muajin e parë në Kuvendin e Kosovës ju shtrova pyetjen se kur planifikoni të rregulloni rrugën që lidh fshatrat e Lugut të Baranit me Lugun e Leshanit, rrugë e cila e ka një rëndësi të veçantë për këta banorë.

Në kuadër të kësaj rruge është edhe ura, që është projekt i veçantë në fshatin Rosujë, e cila ka vite që është në gjendje të mjerueshme, duke rrezikuar jetë të qytetarëve, në veçanti të nxënësve, të cilët e kalojnë çdo ditë këtë urë.

Pyetja ime për ju është: Në Kuvendin e Kosovës kam marrë premtime nga ju që ura në veçanti do të kryhet këtë vit, duke pasur parasysh që edhe projekti është dorëzuar me kohë. Siç po shihet, pra jemi në muajin dhjetor dhe realizimi i kësaj ure është i pamundur.

Prandaj, çfarë mund të ju themi atyre banorëve sot?

KRYESUESI: Zoti Mujota, e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, e nderuara deputete Haxhiu!

E para, dua të sqaroj që projektet e shumta të realizuara në të gjitha komunat e Kosovës kanë qenë një barrë shtesë për Ministrinë e Infrastrukturës edhe mendoj që jemi të gjithë të kënaqur që kemi arritur shumë të bëjmë dhe kemi mbi 95% të rrugëve të asfaltuara në gjitha komunat e Kosovës, në të gjitha vendbanimet e Kosovës.

Komunat kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për ndërtimin e rrugëve lokale dhe besoj se me buxhetin 2014 këto pak rrugë që kanë ngelur besoj se ato do të bëjnë prioritetet e

tyre dhe do të mund të drejtojnë edhe ndonjë kërkesë shtesë që Ministria t'i përkrah, pse jo edhe këtë projekt ekzistues që ju e keni ngritur si çështje.

Ndërsa, për çështjet tjera që më vjen keq që ju s'keni pasur informatën, unë ju tregoj se mbi bazën e procedurave që përcakton Ligji i prokurimit publik, Ministria e Infrastrukturës e ka përfunduar punën e vet, ka bërë të gjithë veprimet e nevojshme dhe tashmë është përzgjedhur operatori ekonomik, kompania punë kryese me të cilën është nënshkruar kontrata më datën 18 nëntor 2013.

Pra, vlera e kësaj kontrate është 323 mijë e 592 euro, punë kryerës do të jetë Kompania "Arda Rei". Pra, është nënshkruar kontrata punimet sigurisht do të ndodhin në pranverë, sepse tash sezoni dimëror nuk e mundëson një gjë të tillë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Agim Kuleta pyetje për ministrin Ismajli. Agim a dëshiron ta bësh pyetjen meqenëse s'është ministri? Zoti Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULETA: Nëse do të mund ministri Beqaj, do ta shtroja pyetjen ka lidhje me kodin telefonik, përndryshe do ta bart në mbledhjen e ardhshme.

KRYESUESI: Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për ministrin Slobodan Petroviq. Ministri s'është këtu, dëshirosh ta bësh pyetjen? Fjalën zotit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Edhe bën pa fol, por nuk bën pa i ngritur disa çështje që janë shqetësim të qytetarëve, të nderuar deputetë dhe këtë e shoh të arsyeshme edhe me rastin e këtij shqetësimi që do të ngre.

Unë besoj që ministrit do t'i përcillet përmes kolegëve të vetë ose këshilltarëve dhe natyrisht që do ta trajtojë këtë shqetësim timin dhe qytetarëve të Kosovës.

I nderuari zoti ministër,

Deklaratat një kryetari të sapo zgjedhur në një komunë ku dominohet nga pakica serbe atakon në sistemin e vlerave kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës dhe shumica dërrmuese e qytetarëve të shtetit tonë e kanë përjetuar si fyerje të ndjenjave të tyre dhe si kërcënim të sigurtisë së vendit tonë.

Në këtë Kuvend e kemi mbështetur amnistinë e përgjithshme të të gjithë atyre që nuk i kanë respektuar Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës dhe me mjaft debat dhe me mjaft përplasje, për t'u dhënë rast që nga momenti i amnistisë ta ndërtojmë të ardhmen e tyre duke e njohur dhe respektuar shtetin e Kosovës dhe doemos vlerat kushtetuese dhe ligjore të vendit tonë.

Pyetje për ministrinë: Do ta toleroni ndonjë kryetar të mos i respektojë detyrimet ligjore me rastin e aktit të betimit dhe gjatë ushtrimit të detyrës së kryetarit të komunës në të cilin është zgjedhur? Nëse do të ketë ndonjë tolerim në këtë çështje, pasojat do të jenë të rënda dhe të shumta, duke filluar në këtë Kuvend me kërkesa për shkarkim dhe nuk dihet pastaj ku do të përfundojnë pasojat, sepse do të krijojnë konotacione të mëdha. Kaq, për këtë shqetësim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi!

Keni edhe një pyetje tjetër për zotin Mujota. Fjalën e ka Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zoti ministër,

E çmoj shumë korrektësinë tuaj në çdo detyrë institucionale që keni kryer deri tani. Nuk kam dyshim dhe i vlerësoj shumë arritjet infrastrukturore në kohën tonë, por megjithatë këto arritje jam i shtrënguar për arsye sigurie të qytetarëve në autostradën nga Gjergjica deri në Prishtinë, t'i trajtojë disa mangësi që në kriteret e përgjithshme nuk duhet t'i kenë pjesë autostradat ku kalojnë nëpër vendbanime.

Me këtë rast do të ndalem në dy nga ato që do të duhej të përmirësoheshin, kyçja e përnjëhershme në autostradë pothuajse në të gjitha vendet ku ka hapësirë të mjaftueshme për të vazhduar me gjatësi të duhur dhe vendosja e mbrojtësve anësor me përmbajtje jo të kushtueshme që do të rrisnin sigurinë e lëvizjeve të qytetarëve dhe të automjeteve përgjatë kësaj pjese të autostradës.

Pyetje ime është përmbledhur kështu për këtë shqetësim: A e shini të arsyeshme të vazhdoni gjatësinë e të gjitha kyçjeve dhe vendosjen e rrethojave mbrojtëse në këtë relacion të autostradës për të vazhduar pastaj me kriteret të tilla në relacione të tjera gjatë ndërtimeve të reja që i ka në projekt Qeveria dhe të cilat janë inkurajuese, natyrisht edhe gëzojnë qytetarin e Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Mujota e keni fjalën.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuar deputetë Haliti,

Faleminderit për pyetjen që keni shtruar.

Rruga nacionale N9 segmenti Fushë-Kosovë - Gjergjicë, në gjatësi prej 27,80 km është ndërtuar me profil të rrugës së shpejtë me shirit ndarës në mes të dy drejtimeve të zhvillimit të komunikacionit. Të gjitha udhëkryqet janë në dy nivele. Kjo rrugë për shkak të kyçjeve dhe objekteve përgjatë rrugës nuk mund të kategorizohet si autostradë, ndërsa mundësitë për ndërtimin e rrugëve ndihmëse për komunikacionin lokal janë të kufizuara për shkak të përqendrimit të madh të objekteve përgjatë rrugës nacionale në fjalë dhe çmimit të shpronësimit të tyre dhe pronave ku janë ato.

Ne planifikojmë të bëjmë një studim për kufizimin e kyçjeve në rrugën nacionale N9 për këtë segment rrugor me qëllim të rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit përfshirë këtu edhe ndërtimin e rrugëve anësore përgjatë këtij segmenti që do varet shumë nga kapacitetet financiare që kemi dhe momentin e duhur për të bërë këtë rrugë edhe më funksionale.

Me zgjerimin e rrugës nacionale N9 nuk ka ngecje në komunikacion, prandaj megjithatë Ministria e Infrastrukturës me ekspertë të sigurisë së komunikacionit e ka në kujdes të përhershëm gjendjen e sigurisë këtë segment rrugor dhe do t'i ndërmarrë masat e nevojshme për siguri të vazhdueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Krasniqi?

HALIT KRASNIQI: Nuk do ta quaja pyetje shtesë, është një koment. Jam i vetëdijshëm se ka një vëllim të madh të punëve ministri dhe shkallën e përgjegjësisë së tij e vlerësoj jashtëzakonisht shumë, kam dashur ta sensibilizoj ministrin dhe Ministrinë, kam dashur ta ... rutinën e angazhimeve të përditshme dhe të nënvizojë një shqetësim të qytetarëve dhe natyrisht që edhe unë dhe qytetarët besojmë shumë në impenjimin e ministrit dhe të Ministrisë me këto shqetësime dhe besoj shumë se do të bëhet e mundur ndonjë korrigjim ku ato kushte janë të favorshme për profesionalistët. Faleminderit për përgjigjet!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që edhe pika e dytë e rendit të ditës me pyetjet e deputetëve është shteruar. Po vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, zotin Bujar Bukoshi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që para jush të paraqes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj është miratuar nga Qeveria, më 11 tetor të këtij viti. Projektligji ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e nenit 12, paragrafi 6, të ligjit bazik që ka të bëjë me përbërjen e Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Ligji nr. 04/ L - 199 nxori në pah nevojën për ndryshimin e këtij ligji dhe për dallim nga përbërja aktuale e Këshillit Konsultativ, me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji në Këshillin Konsultativ për Komunitete përfshihet edhe një përfaqësues nga bashkësia e komunave me shumicë serbe në Kosovë.

Projektligji është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në përputhje me Kushtetutën tonë dhe me standardet e Bashkimit Evropian, përveç kësaj nuk krijon shpenzime shtesë për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Andaj, ju propozoj që këtë projektligj ta miratoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër Bukoshi. Radhën e ka kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për të Drejta, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, zonja Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem predsedavajući, Komisija za prava i interese Zajednice i povratak je takođe bazirajući se na član 56 stav 2 Poslovnika Skupštine održala sastanak Komisije 3.12.2013. godine razmatralo je u načelu pomenuti Zakon o zaštiti i promovisanju prava zajednica njihovih pripadnika i odlučila da Skupštini podnese preporuku o usvajanju u načelu gore pomenutog zakona.

Takođe i poslanička grupa Samostalne liberalne stranke će glasati za usvajanju ovog zakona u načelu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!

Radha është e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zoti Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, nënkryetar i Parlamentit!

Përsëritje për Kabinetin qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar këtë ligj dhe rekomandon që ky të miratohet. Realisht, është pjesë e një ligji që është miratuar më herët, është plotësim ndryshimi të cilin ne e akceptojmë si të tillë dhe e mbështesim tërësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, e ka fjalën zonja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit! I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka shikuar se arsyeja për të cilin është kthyer ligji më herët është përsëri e njëjtë për t'u refuzuar ngase nuk ka sjell ndryshimet të cilat janë kërkuar në vërejtjet tona më herët.

Terminologjia e përdorur po ashtu nuk është e përshtatshme, për arsye se përdoret “bashkësia e komunave” e cila nuk është kështu në ligj dhe gjithashtu pjesa e kostos buxhetore është jo e përputhshme nga Departamenti i Buxhetit dhe nga Zyra e Kryeministrit. Derisa qëndrojnë këto vërejtje që janë mjaftë parimore, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk do ta votojë ligjin, ndryshimet në projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, këtu me vete i kam të tri ligjet. Ligji i parë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve i cili u pat miratuar në këtë Kuvend, në mars të vitit 2008, ndryshimi i atij ligji në dhjetor të vitit 2011 dhe tash na vjen ndryshimi tjetër i këtij ndryshimi të fundit për Këshillin Konsultativ të Komuniteteve.

Ndryshimet mes ligjit të parë dhe të dytë që nëpërmjet ndryshimit që vjen te ligji i dytë, ajo që shtohet është “komuniteti malazez dhe ai kroat”, të cilët i shtohen ligjit ekzistues, kurse tash na vjen ndryshimi tjetër që ligjit aktual t'i shtohet edhe një përfaqësues në

Këshillin e Komuniteteve, i cili do të vinte nga Bashkësia tash e themeluar e komunave serbe në negociatat e Brukselit.

Këtu në Kosovë po na krijohet një praktikë krejtësisht e gabuar e ndryshimeve ligjore, të cilat vijnë si pasojë e kushtëzimeve të ndryshme. Kryeministri dhe zyrtarët e ndryshëm qeveritarë kur patën hyrë në negociata me Serbinë, patën premtuar se meqenëse po bisedohet për çështje të brendshme të Republikës së Kosovës, atëherë nuk do të preket fare korpusi ligjor i shtetit tonë.

Dhe, ja ku e keni shembullin konkret që ata nuk e kanë treguar të vërtetën, sepse ky ligj që na ka ardhur sot është fakt i drejtpërdrejtë që tregon se si Serbia dhe kërkesat e saj po na bëjnë ndryshime ligjore brenda shtetit tonë. Meqë bashkësia e komunave serbe u krijua në negociatat e Brukselit mes Thaçit dhe Daçiqit, tash kësaj bashkësie po ia garantojnë një vend edhe në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve.

Kjo do të thotë që Serbia jo vetëm që po bëhet përcaktuese e legjislacionit tonë, por po bëhet kështu edhe përcaktuese e strukturës institucionale të Republikës së Kosovës. Çdo lëshim që kryeministri po ia bën Daçiqit po na vjen këtu në Kuvendin e Kosovës në formë të ndryshimeve të reja ligjore. Ky është një shembull shumë i keq i shtetndërtimit. Këto kompromise që po na i sjell kryeministri Thaçi janë vërtetë të papranueshme, aq më tepër kur dihet fare mirë që kjo Bashkësia e Komunave Serbe nuk do ta pranojë shtetin e Kosovës.

Tashmë dihet që 9 kryetarët të komunave serbe pas zgjedhjeve të fundit lokale dolën me deklaratimet e tyre fare haptazi se nuk do ta pranojnë Republikën e Kosovës. Të deklarosh se nuk do ta njohësh Republikën e Kosovës nuk është pozicion pasiv, por kjo do të thotë që ata janë deklaruar se do ta luftojnë shtetësinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Në vend që ata të cilët janë kundër pavarësisë së Kosovës, të kundërshtohen dhe fuqia e tyre të zvogëlohet, Qeveria e Kosovës, me vendimet e saj po e rrit fuqinë e eksponentëve të Serbisë brenda Kosovës. Kjo nuk i kontribuon stabilitetit, por përkundrazi është një gjë e cila e destabilizon shtetin e Kosovës.

Përfaqësuesit e Serbisë po e rrisin ndikimin brenda Kosovës, sepse deri dje ishin dhe trajtoheshin si struktura ilegale, kurse sot po bëhen kryetarë komunash, po krijojnë entitete komunale brenda Kosovës dhe po hyjnë me përfaqësuesit e tyre edhe përbrenda institucioneve të Republikës së Kosovës me qëllimet e tyre obstruktive.

Kjo po e krijon një konstelacion tejet të pafavorshëm edhe mes vetë pakicave. Tash do të jetë edhe më e vështirë ta gjesht një qytetarë serb brenda këtyre komunave, i cili është lojal dhe e pranon shtetin e Kosovës, sepse ata do të jetojnë nën pushtete lokale të cilat marrin urdhra drejtpërdrejt nga Beogradi.

Dhe, ashtu sikurse që ndodh nëpër komunat e partisë në pushtet që kush është me partinë, shpërblehet, kurse kush mendon ndryshe, dënohet, nëpër komunat e fituara nga Iniciativa e Daçiqit, tash kush e pranon Republikën e Kosovës, do të pësojë, kurse kush e kundërshton shtetin e Kosovës, do të vlerësohet.

Këto do të jenë ato standardet politike se si do të funksionojë Bashkësia e Komunave Serbe karshi shtetit dhe Republikës së Kosovës.

Për krejt këtë gjë, të cilin lëvizja “Vetëvendosje” si rrezik e ka paralajmëruar vite më parë, unë mendoj që duhet të mbahet përgjegjëse Qeveria e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së nuk është lajmëruar askush. Nga Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re e ka fjalën kryetarja e Grupit, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit! I nderuar nënkryetar i Kuvendit! Përsëritje për zëvendëskryeministrin dhe ministren dhe të gjithë deputetët, Duke marrë parasysh se ky shqyrtim i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, ka qenë edhe njëherë në lexim në Kuvend dhe është kthyer dhe duke marrë parasysh rrethanat e tashme në të cilat ndodhet Kosova pas marrëveshjeve teknike dhe pas disa ndryshimeve që do të bëhen edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, koalicioni për Kosovë të Re do t'i japë përkrahje këtij projektligji.

KRYESUESI: Faleminderit! SLS nuk është paraqitur. Nga “Zajednička Budućnost”, fjalën e ka Sasha Gjokiq.

SAŠA ĐOKIĆ: Hvala gospodine potpredsednike! Poštovanje zamenika premijera, Poštovanje ministru Bajramiju Rexhepiju. Ja ću samo kratko da obrazložim. Poslanički klub “Zajednička Budućnost” će podržati Zakon o zaštiti i promovisanju prava zajednica i naših poslanici će dati svoj doprinos kroz odborima u Skupštini.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur, unë kam si obligim që t'ua lexoj pjesën e këshillave juridike, pastaj të vendosim edhe pse mendoj që nuk janë 58 deputetë, bjeri ziles, thuaju atyre.

Për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe shumicës së deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë, neni 81 paragrafi 1, pika 1 e Kushtetutës, amendamenti 2.

Pra, kërkohet numri 61 i votave “për” nga deputetët e Kuvendit, prej tyre 13 vota “për” nga deputetët e komuniteteve në pakicë. Unë kërkoj që të bëhet numërimi i deputetëve të komuniteteve pakicë a e kanë numrin 13, a janë 13 deputetë të komuniteteve pakicë në sallë me qëllim që ta hedhim në votim ose jo? Në qoftë se nuk janë, atëherë votimi nuk është valid.

Janë 12 deputetë, doli Myfera Shinik. Ne mund të votojmë, por votimi s'është valid në qoftë se nuk votojnë 13 të pakicave.

Po e thërras atë gruan, në qoftë se nuk vjen e lëmë këtë punë edhe e shtyjme votimin kur janë të pranishëm deputetët. A po vjen ajo a jo? Konstatohet që në sallë janë 66 deputetë, prej tyre janë 13 pakicë dhe kushtet janë të mundshme për votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Nuk e di a kanë votuar të gjitha pakicat? Duhet ta kem nga regjia, a kanë votuar 13 veta nga pakicat, por konstatohet që 32 vota janë kundër, 35 për.

S'i kemi 61 vota, nuk miratohet.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Komisioni Funkcional, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Beqaj, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ministria e Financave ka filluar hartimin e Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2012, pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte propozuar plotësim-ndryshimin e ligjit ekzistues, i cili rregullon funksionimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Ndonëse fillimisht ishte iniciuar plotësimi dhe ndryshimi i ligjit ekzistues, gjatë procesit të hartimit të tij nga ana e Komisionit qeveritar për hartimin e projektligjit, pjesë e të cilit ishte edhe vetë Auditori i Përgjithshëm, është parë e nevojshme që të shkohet me një ligj krejtësisht të ri, pasi ligji ekzistues kishte shumë mangësi dhe rezultat i këtij numri i ndryshimeve ishte tejet i madh.

Duhet cekur se Ministria e Financave ka filluar me plotësim-ndryshimin e këtij ligji me qëllim të përfshirjes së rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, por edhe duke e parë të nevojshme hartimin e një ligji gjithëpërfshirës të detajuar, i cili e rregullon në tërësi funksionimin e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, prandaj Komisioni qeveritar i propozuar nga Ministria e Financave e ka hartuar një projektligj krejtësisht të ri i cili i plotëson të gjitha këto kritere.

Auditorit të Përgjithshëm përmes këtij projektligji i sigurohet një pavarësi e lartë, ashtu siç e parasheh edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe standardet ndërkombëtare të kësaj fushe.

Konsiderojmë se me miratimin e këtij ligji do të evitohen edhe paqartësitë ekzistuese sa u përket fushave të auditimit, formës së përmbajtjes së tyre, të cilat janë të përkthyer në mënyrë detale në këtë projektligj.

Është me rëndësi të përmendet fakti që dispozitat e këtij ligji parashohin edhe bashkëpunimin e Auditorit të Përgjithshëm me institucionet zbatuese të ligjit për të raportuar në raste të shkeljeve të rënda të ligjit të cilat mund të përbëjnë vepër penale.

Ky projektligj është vlerësuar edhe nga Komisioni Evropian dhe aktorët tjerë të përfshirë në procesin e hartimit të tij.

Projektligji ka rregulluar edhe mënyrën e bashkëpunimit me të gjitha institucionet publike me Auditorin e Përgjithshëm dhe ofrimin e informatave për procesin e auditimeve, prandaj, të nderuar deputetë, duke konsideruar këtë projekt tejet të rëndësishëm, rekomandoj që të miratohet në lexim të parë dhe ndërmjet të dy leximeve do të bashkëpunojmë edhe një herë me të gjithë deputetët për të ardhur në leximin e dytë me amendamentet e nevojshme nëse ka disa prej tyre nga ana e deputetëve të Kuvendit, prandaj ju ftoj që ta votojmë në lexim të parë sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zotit Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëritet për ju, për ministrat,

Kolegë deputetë të nderuar,

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, në bazë të nenit 56, paragrafit 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhjetor 2013, shqyrtoi në parim Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditorit të Republikës së Kosovës, numër 04/L-236.

Ky projektligj ka për qëllim evidentimin e paqartësive dhe mangësive të ligjit aktual dhe ky projektligj nxirret për sigurimin e një niveli më të lartë të pavarësisë së Auditorit të Përgjithshëm konform praktikave më të mira.

Projektligji e rregullon organizimin, veprimtarinë dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, ky ligj e përcakton fushëveprimin për auditimin e jashtëm të fondeve publike, ekzekutimin e buxhetit, përdorimit dhe qeverisjen e burimeve publike, rrit nivelin e transparencës në funksionimin e Auditorit të Përgjithshëm.

Me këtë projektligj do të harmonizohen definicionet e vjetruara me standarde ndërkombëtare.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike gjatë shqyrtimit në parim të Projektligjit ka vlerësuar se i njëjti i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Ky konstatim është edhe i Grupit Parlamentar të LDK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zonja Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit në Republikën e Kosovës.

Ne si grup në parim e mbështetim këtë projektligj, sepse ka qenë më se i domosdoshëm aprovimi i një ligji të mirë për këtë zyrë, i cili do të ndikonte në rritjen e mëtutjeshme të funksionalitetit të saj.

Është shumë e rëndësishme që Kuvendi i Republikës së Kosovës me këtë ligj të kontribuojë në përforcimin e këtij institucioni, por me qëllim që ky ligj t'i përmbushë sa më mirë nevojat për të qenë institucion sa më kredibil në lidhje me përmbajtjen e tij. Në vazhdim ne do t'i paraqesim disa vërejtje.

Te neni 4 i Projektligjit thuhet: Nëpërmjet këtij ligji themelohet Zyra Kombëtare e Auditimit, si një institucion i pavarur. Është e pakuptimtë të propozohet themelimi i një institucioni i cili është themeluar dhe funksionon që nga viti 2002 dhe nuk do të ishte mirë që të shihet veprimtaria e këtij institucioni kaq të rëndësishëm për Republikën e Kosovës.

Ajo çka ne pajtohemi është që ky nen duhet ta përmbajë propozimin për ndryshimin e emrit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në Zyre Kombëtare të Auditimit.

Te neni 8 i Projektligjit ku përcaktohet struktura e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ne mendojmë se pozita e sekretarit të përgjithshëm është dualiste me atë të Auditorit të Përgjithshëm dhe është krejt e panevojshme për strukturën e kësaj zyre.

Ne propozojmë që në strukturë të zyrës është shumë e rëndësishme të jenë të përcaktuara nivelet për drejtorë të departamenteve, udhëheqësit e ekipeve dhe nivelet e tjera.

Te neni 9 i Projektligjit propozohet menaxhmenti i zyrës dhe specifikohet zgjedhja e stafit menaxhues të zyrës pas një konkursi të hapur publik ku detajet rreth emërimit të kushteve dhe punës do të caktohen në pajtim me nenin 10 të këtij ligji.

Për sqarim neni 10 i këtij projektligji thotë se Auditori i Përgjithshëm përcakton përmes një rregulloreje të brendshme organizimin dhe menaxhimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Përderisa përzgjedhja e stafit menaxhues propozohet të rregullohet me këtë ligj, në anën tjetër përzgjedhja e pjesës tjetër të stafit propozohet të mbetet pjesë e vendimmarrjes së Auditorit të Përgjithshëm, duke nxjerrë rregullore të brendshme në lidhje me këtë. Ne

mendojmë se përzgjedhja e stafit menaxhues, si dhe e stafit tjetër duhet të bëhet sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Te neni 15 thuhet se Ligji për shërbyesit civilë dhe Ligji për pagat e shërbyesve civilë nuk gjejnë zbatim për Auditorin e Përgjithshëm.

Ne mendojmë se Ligji për shërbyesit civilë duhet të zbatohet për tërë stafin, sepse do të krijonte siguri më të madhe për ushtrimin profesional të detyrave dhe do t'i evitonte mundësinë e ndikimit të menaxhmentit mbi auditorët, pjesën kruciale të kësaj zyre.

Është shumë e rëndësishme që stafi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të mbetet si shërbyes civil, sepse Ligji për shërbyesit civilë është mbrojtës për secilin punëtor dhe secilit sektor në Republikën e Kosovës, ashtu siç është edhe ndëshkues për ata të cilët nuk e zbatojnë këtë ligj.

Prandaj, konsiderojmë e mbetja e stafit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm si shërbyes civilë do të garantonte pavarësi të stafit apo edhe ndëshkim se sa me rregullore të brendshme siç pretendohet të nxjerrën nga Auditori i Përgjithshëm pas aprovimit të këtij ligji.

Shtrohet pyetja: Kujt do të mund t'i drejtohet stafi i këtij institucioni për t'i mbrojtur të drejtat e tij si i punësuar, nëse fati i tyre do të varet ekskluzivisht nga një rregullore e brendshme.

Ndërsa sa i përket pavarësisë financiare kjo zyrë duhet të ketë pavarësi të plotë financiare sa i përket pagave për stafin e saj, duke krijuar një bazë të shëndoshë të shpërblimit të tyre konform natyrës dhe rëndësisë së kontributit që ofrojnë, prandaj ne si Grup Parlamentar do ta japim kontributin tonë lidhur me këtë ligj në grupin punues dhe komisionet përkatëse, pas miratimit në parim.

Unë ju ftoj ta votoni në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri e ka fjalën, me kartelë të Lutfi Hazirit.

ISMET BEQIRI: Për këtë shkak, ju kërkoj falje zoti kryesues, desha ta jap një sqarim. Në votimin paraprak ka qenë kartela e Lutfiut, domethënë është një ngatërrim dhe vota që figuron është votë imja, prandaj, për hir të transkriptit lë të jetë e qartë që shpeshherë kjo ndodh që të flitet me kartelë në emër të dikujt tjetër, desha të sqaroj se vota që është aty është votë e Ismet Beqirit, do të thotë imja me kartelë të Lutfi Hazirit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi juaj parlamentar nuk është paraqitur që të diskutojë dikush. Këtë e tha Aliu. Në rregull. Në emër të “Vetëvendosjes”, zoti Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

Duke qenë se politikat financiare brenda organizimit shtetëror zënë një vend të veçantë për funksionimin e drejtë dhe efektiv të organeve shtetërore është më se e rëndësishme që të krijohen edhe politika të qëndrueshme të kontrollit dhe revizionit financiar.

Nuk ka dyshim se edhe në aspektin e kontrollit financiar funksionimi i një organi të pavarur i cili do të konstatojë gjendjen faktike dhe juridike të mbarëvajtjes financiare të organizatave buxhetore është crucial sa i përket menaxhimit të financave publike. Zaten, i gjithë funksionimi i aparatit shtetëror varet nga menaxhimi financiar, sepse financat në fakt janë derivat i administratës publike dhe jo vetëm kaq, ngritja e nivelit të përgjegjësisë lidhur me çështjet që ndërlidhen me kontrollin financiar ndikon edhe në uljen e shkallës së korrupsionit dhe keqpërdorimeve të ndryshme me të cilat fatkeqësisht sot shteti i Kosovës është duke u ballafaquar në masë të madhe.

Për këtë institucioni i pavarur kushtetues siç është Auditori i Përgjithshëm ka rol të rëndësishëm në aspektin e ushtrimit të kontrollit dhe revizionit financiar. Është e pamundur që të bëhet një kontroll dhe revizion i qëndrueshëm për deri sa pavarësia e këtij institucioni është i destabilizuar dhe i cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Deri më tani Auditori i Përgjithshëm, edhe pse ka adresuar rekomandime dhe të gjetura gjatë auditimit të aktivitetit financiar ligjor të organizatave buxhetore mbetet pjesa kritike që ka të bëjë me ushtrimin e trytnisë dhe anashkalimin e kritikave të bazuara që ndërlidhen me keqmenaxhimin e parave publike.

Ne kemi një ballafaqim të vazhdueshëm me keqmenaxhimin e financave publike që sot shihet se në masë të duhur nuk është adresuar edhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Në këtë drejtim duhet pasur parasysh se edhe me strukturën e re ligjore e cila është duke u shqyrtuar nga Kuvendi i Kosovës, duhet të kihet parasysh se përvoja nga e kaluara duhet të jetë në shërbim të sendërtimit të një infrastrukture juridike të qëndrueshme në funksion të drejtë dhe të efektshëm.

Po ashtu, ne jemi të vetëdijshëm se zbatimi i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë si dhe Ligjit për financat e pushtetit lokal është i ndërlidhur edhe me ushtrimin e kontrollit dhe revizionit financiar.

Po ashtu, jemi të bindur se diskrepanca në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal shpeshherë ka qenë shkas i krijimit të zbrazëtirave për keqpërdorimin e parave publike dhe keqmenaxhimit të saj.

Në këtë drejtim ne duhet të kemi parasysh se funksionimi i drejtë i Auditorit të Përgjithshëm është përcaktuar që në mënyrë të pavarur të konstatohet kualiteti i menaxhimit të parave publike, që realisht është ndër çështjet më të rëndësishme të shtetit të Kosovës.

Vërejtje ndaj Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke marrë parasysh se Projektligji për Auditorin e Përgjithshëm është akt ligjor dhe formal, nuk vihet në diskutim fare harmonizimi i praktikave të hartimit të legjislacionit në Republikën e Kosovës.

Në këtë drejtim shihet se në projektligj pjesa e përkufizimit është futur në nenin 1 dhe kjo rëndom e paraqet disproporcionin përmbajtësor të Projektligjit me aktet tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Andaj neni mbi qëllimin dhe fushëveprimin e ligjit do të duhej të renditej në fillim të projektligjit.

Në neni 2 dhe 3, po thuaj se në mënyrë të përgjithshme kemi përshkrimin nga ligji i vjetër për Auditorin e Përgjithshëm, gjë që pasqyron se hartuesi nuk ka treguar kreativitet të mjaftueshëm që në suaza të një ligji të ri të formulohen dispozitat me përmbajtje krejtësisht tjetër.

Te kushtet e përzgjedhjes së Auditorit të Përgjithshëm, në nenin 3, paragrafi 5, nën paragrafi 5.1, theksohet se duhet të ketë përvojë prej së paku 8 vjet në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, financave publike ose administratës publike.

Ky propozim përbën periudhën më të shkurtër nga ligji që është në fuqi prej dy vjet më pak. Pse të shkurtohet kushti i përvojës në dallim prej ligjit që është në fuqi, a mund që t'i jenë përshtatur këto kushte individit me përkrahje politike, sidomos kur kihen parasysh kushtet e përgjithshme, siç është puna në administratën publike?

Në paragrafin 9 të nenit 3 të Projektligjit konsiderojmë se do të duhej ta dorëzonte një raport të detajuar për punën e tij për periudhën e fundit tremujore si kusht tjetër që duhet të përmbushet para aktit të dorëheqjes.

Kjo do të ndikonte në sigurinë juridike me qëllim të konstatimit sa më efikas të përgjegjësisë së tij.

Po ashtu në paragrafin 11 të nenit 3, nuk është e drejtë që të ngushtohet fajësia vetëm lidhur me shqiptimin e dënimit me burgim, duhet pasur parasysh se natyra e funksionit të Auditorit të Përgjithshëm është e lidhur ngushtë me kualitetet morale, andaj përkufizimi do të duhej të shtrihej në çfarëdo kryerje të veprës penale pa marrë parasysh masën e dënimit i cili u ka shqiptuar.

Paragrafi 11.4 është i pakuptimtë, sepse është e ditur se vetëm ndaj personave juridikë zbatohet falimentimi dhe ndaj personave fizikë, andaj si kusht tjetër për shkarkimin e tij nuk do të duhej të ishte ky kushti i pamundshëm juridikisht.

Neni 7 i cili i jep Gjykatës Kushtetuese autorizimin për të vendosur lidhur me kompetencat ligjore, mund të jetë sanksionim me nenin 113 të Kushtetutës, pasi që në këtë dispozitë kushtetuese nuk gjendet asnjëra nga autorizime të Gjykatës Kushtetuese për të vendosur për këtë çështje.

Në nenin 13 paragrafi 2, të Projektligjit, në fund të paragrafit do të duhej të shtohet edhe obligimi për të ndjekur procesin buxhetor të përcaktuar me Ligjin për buxhetin, kjo pasi ligji për buxhetin është ligj determinues për zbatimin e Ligjit për menaxhimin e financave dhe të përgjegjësisë.

Dhe në nenin 29, paragrafi 1 lidhur me ruajtjen e dokumentacionit të klasifikuar periudha prej 7 vjetëve do të duhej të ndërlihet me parashkrimin e ndonjë nga veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe korrupsionit në mënyrë që të sigurohet se në momentin e asgjësimit të dokumentacionit vepra penale që është kryer dhe do të mund të

vërtetohej mbi bazën e dokumentacionit të klasifikuar, është përshkruar dhe si e tillë është e panevojshme.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë këtë projektligj, ndërsa kontributin tonë do ta japim në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, e ka fjalën zoti Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është në njohuri për nismën e Qeverisë për Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, numër 04/L-236.

Me qëllim të ketë një kontroll më të lartë të institucioneve të menaxhimit të parasë publike, si dhe me qëllim të evitimit të paqartësive dhe mangësive të ligjit aktual, po ashtu me qëllim që të ketë një siguri më të lartë të pavarësisë së Auditorit të Përgjithshëm konform praktikave më të mira dhe në harmoni me standardet e auditimit, është propozuar ky projektligj.

Në këtë projektligj rregullohet organizimi, veprimtaria dhe kompetenca e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës. Po ashtu projektligji përcakton fushëveprimin për auditimin e jashtëm të fondeve publike, ekzaminimin e buxhetit, përdorimin dhe qeverisjen e burimeve publike, rrit nivelin e transparencës në funksionimin e Auditorit të Përgjithshëm.

Po ashtu, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka aprovuar në parim këtë projektligj dhe ka vlerësuar se i njëjti i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratimin në parim.

Grupi Parlamentar i Aleancës ka dy vërejtje në këtë projektligj. Ka vërejtje të neni 4 dhe të neni 8. Te neni 4 besoj se kjo zyrë është e formuar prej vitit 2002 dhe ka nevojë ndoshta të riformulohet, ndërsa te neni 8 nuk ka nevojë të ketë një pozitë të re, mirëpo besoj që mendimin do ta japim në leximin e dytë si grup parlamentar.

Në parim si Grup Parlamentar do ta votojmë dhe në leximin e dytë do t'i japim propozimet tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, fjalën e ka kryetarja e Grupit, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Duke marrë parasysh qëllimin e këtij ligji dhe çështjen se çka do të performojë ky ligj në rast se kalon në leximin e parë dhe të dytë, mund të themi se ligji është i një rëndësie të veçantë, mirëpo ka disa probleme të cilat gjatë amendamentimit besoj se do të pësojë

ndryshimin e duhur dhe do të jetë ndoshta ligji në të cilin do të shihet më së miri çështja e planifikimit dhe menaxhimit të parasë publike.

Në parim Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të Qeverisë së Kosovës,

Pas leximit të Projektligjit me të cilin rregullohet organizimi, veprimtaria dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm, shihet se i njëjti përmban një varg dispozitash që nuk janë të nivelit me rëndësinë që e ka ky institucion për vendin tonë.

Konkretisht fjalën e kam për dispozitat e nenit 3, i cili nen është mjaft voluminoz, mund të thuhet se janë dispozitat tejet konfuze të sistemuara në mënyrë jo të mirë dhe të shpërndara nëpër paragrafë me një radhitje të palogjikshme.

Kur them se paragrafët e këtij neni kanë radhitje të palogjikshme kam parasysh faktin se paragrafi i parë trajton llogaridhënien e auditorit, paragrafët 2 dhe 3 rregullojnë pavarësinë e punës së auditorit, paragrafi 4 rregullon emërimin e tij, kurse në paragrafët pasuese rregullohen kushtet dhe kriteret që duhet plotësuar personi për t'u emëruar në këtë pozitë, e pastaj trajtohet mbetja e zbrazët e pozitës së tij për të kaluar te paga, më tutje dorëheqja, ushtruesi i detyrës dhe në paragrafin e fundit trajtohet siç thuhet në të largimi nga detyra, e jo shkarkimi.

Sipas mendimit tim, nga teksti i këtij neni duhet riformulohen tre, respektivisht katër nene të tjera në të cilat do të rregulloheshin në mënyrë shumë të logjikshme dhe më të strukturuar çështjet që janë përmendur në nenin 3.

Një vërejtje tjetër serioze që mund t'i bëhet nenit 3, ka të bëjë me paragrafin 4 të tij, ku në mënyrë tejet të përgjithshme përmendet procedura e emërimit të auditorit.

Unë vlerësoj se së pari duhet të diskutohet se auditori a duhet të emërohet apo të zgjidhet nga Kuvendi dhe së dyti procesi i propozimit të kandidatëve për auditorë nga Komisioni përzgjedhës, i cili caktohet nga presidenti i Kosovës duhet të rregullohet në mënyrë të detajuar me dispozitat e këtij ligji duke përcaktuar se si themelohet komisioni, cilat janë procedurat e aplikimit të kandidatëve për auditorë, cilat janë procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve që i propozohen Kuvendit, si dhe çështjet tjera relevante për këtë proces e jo të trajtohet në mënyrë kaq të zbehtë, jo të precizuar dhe jo shumë të qartë çështja e zgjedhjes së auditorit.

Po ashtu, edhe në paragrafin 5 të këtij neni, ku theksohen kriteret që duhet poseduar personi që konkurren për auditor, mendoj se duhet shtuar edhe një kriter të ri, që duke pasur parasysh rëndësinë, kompetencat, funksionet, por edhe pagën e paraparë për këtë

pozitë, mendoj që kandidati për këtë post duhet të ketë së paku 5 vjet përvojë pune menaxheriale.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me nenet 9 dhe 10 të këtij ligji, të cilat sipas mendimit tim auditorin mund ta shndërrojnë në një mbret të vogël të një institucioni të rëndësishëm dhe të pavarur. Konkretisht, neni 10 ia njeh të drejtën auditorit që me një rregullore të brendshme të përcaktojë organizimin, menaxhimin dhe funksionimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, kurse me paragrafin 2 të nenit 9, përcaktohet që auditori emëron një zëvendës, dy asistentë auditorë dhe sekretarin e përgjithshëm sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me Rregullore që do t'i nxjerrë auditori konform nenit 10.

Një zgjedhje e këtillë ligjore siç është paraparë me këtë draftligj nuk e përjashton mundësinë që auditori me rregullore të brendshme dhe kompetencat që i jep ky projektligj, t'ua përshtatë kushteve dhe të emërojë në pozita të lartë theksuara miqtë dhe familjarët e tij.

Prandaj, me qëllim të shmangies së një situate të tillë të mundshme propozoj që kushtet dhe procedurat për emërimin e këtyre zyrtarëve të përcaktohen me ligj e jo me rregullore të brendshme të miratuara nga vetë auditori.

Më tutje në nenin 12, paragrafi 2 thuhet se Auditori i Përgjithshëm mundet që përmes kontratës apo punësimit të angazhojë çfarëdo personi. Mendoj se ky pasus përveç shprehjeve jo adekuate ligjore si shprehja përmes punësimit dhe shprehja çfarëdo personi, ka edhe përmbajtje jo të arsyeshme, sepse auditorit i jep kompetenca të jashtëzakonshme që të angazhojë persona të ndryshëm në cilësinë e ndihmësve të Zyrës së Auditimit.

Po ashtu, vërejtje mund t'i bëhet edhe nenit 24 ku thuhet se auditori njofton autoritetet e zbatimit të ligjit kur janë vërejtur tregues të shkeljeve të rënda. Duke pasur parasysh se shprehja “shkeljet e rënda” nuk është sqaruar me nenin e parë, pra te përkufizimet e këtij ligji, vlerësoj se ky pasus duhet riformuluar dhe shkruar kështu:

“Auditori i Përgjithshëm ka për obligim t'i njoftojë organet e zbatimit të ligjit për çdo rast kur dyshohet se është kryer ndonjë vepër penale, të përcaktuar me Kodin Penal të Kosovës apo me aktet tjera normative në fuqi”.

Dhe, së fundi, këtij ligji mund t'i bëhen vërejtje serioze edhe për shprehjet terminologjike dhe formulimit, të cilat vende-vende janë të pakuptimta ose lënë mundësinë e interpretimeve të shumëfishta. Për shembull, në nenin 3 paragrafi 11 pika 2, haset shprehja: “merret me punë të pahijshme dhe të pasjellshme”.

Neni 19 pika 1, aktivitetet në pajtim me ligjin e tanishëm; Neni 19 pika 12 publikon standardet e auditimit që përdoren.

Andaj, propozoj që gjatë shqyrtimit të mëtejme Komisioni Funkcional, përveç inkuorporimit të vërejtjeve përmbajtjesore t'i ketë në konsideratë edhe përmirësimet terminologjike dhe gjuhësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Fjala është e Qeverisë, në qoftë se Besimi e dëshiron fjalën? Jo. Konstatohet se në sallë janë 52 veta. Nuk kemi kuorum për të votuar, bëjmë pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Problemi është që menjëherë kemi votim që ta kryejmë pikën e katërt, të pestë, të gjashtë. Tash mund të vazhdojmë me pikën e shtatë.

A të shkojmë tek pika e shtatë?

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadergjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me planin e punës për vitin 2013, në kuadër të përgjegjësisë për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Me qëllim të përmbushjes së aktivitetit mbikëqyrës, komisioni ka krijuar grupin punues, në përbërje të secilit kanë qenë pesë anëtarë të komisionit, ndërkaq raportues i grupit ka qenë Latif Gashi. Grupi punues ka hartuar dhe aprovuar planin e veprimit, në të cilin janë përcaktuar institucionet që janë përgjegjëse të drejtpërdrejta në zbatimin e ligjit.

Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për prokurim publik në Republikën e Kosovës, është vlerësimi i zbatueshmërisë në praktikë të këtij ligji, duke u bazuar në të dhënat nga dëgjimet në ministritë, operatorët ekonomikë, komunat dhe institucionet tjera.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për prokurim publik, grupi punues ka arritur të mbledhë të dhëna të mjaftueshme për nivelin e zbatimit të ligjit. Në bazë të të gjeturave, nga vizitat në terren, grupi punues ka bërë këto veprime.

- Vlerësimin se cili është niveli i zbatimit të Ligjit të prokurimit publik;
- Identifikimin e çështjeve të ngritura nga palët, institucionet me të cilat Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur takime dhe rekomandimet, domethënë janë propozuar masa konkrete që duhet të ndërmerren për të lehtësuar zbatimin e këtij ligji.

Grupi punues sipas planit të veprimit ka realizuar 16 vizita në terren në nivele të ndryshme institucionesh, institucione të nivelit qendror, ku ka vizituar: Ministrinë e

Shëndetësisë, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Integritetit Evropian, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencinë Qendrore të Prokurimit.

Nga institucionet e pavarura ka vizituar: Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Dhe po ashtu, janë bërë hulumtime edhe në Komunën e Prishtinës, Komunën e Graçanicës, Ferizajt, Prizrenit dhe Komunën e Pejës.

Komisioni po ashtu ka realizuar një dëgjim publik me operatorët ekonomikë dhe është takuar me persona përgjegjës të cilët janë përgjegjës të drejtpërdrejt në zbatimin e ligjit.

Grupi punues për monitorim gjatë vizitës në institucionet e lartpërmendura dhe shqyrtimit të dhënave ka ardhur në përfundim se Ligji për prokurim publik në pjesën më të madhe ka gjetur implementim efikas, domethënë ka gjetur zbatueshmëri efektive nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik dhe në të gjitha organizatat buxhetore, si ato të nivelit qendror, po ashtu edhe ato të nivelit lokal.

I tërë procesi i prokurimit, duke filluar nga nxjerrja e akteve nënligjore nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të nevojshme për implementimin e Ligjit të prokurimit, themelimi i tavolinës ndihmëse, e cila u ofron ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese të operatorëve ekonomikë, monitorimin dhe mbikëqyrjen e autoriteteve kontraktuese për zbatimin e ligjit.

Si sfida kryesore është identifikuar çështja e rritjes së shkallës së monitorimit aktivitetëve të prokurimit, ushtrimi i funksionit të Agjencisë Qendrore të Prokurimit për blerje të centralizuara, ku bëhet identifikimi i artikujve të përdorimit të zakonshëm, artikuj të cilët mund të blihen në mënyrë më efektive nëpërmjet aplikimit të procedurës së përbashkët.

Mosëmrimi i drejtorit të Agjencisë Qendrore të Prokurimit vite me radhë këtu kjo Agjenci udhëhiqet nga një ushtrues detyre. Mosëmrimi i anëtarëve të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, anëtarëve të Bordit të OSHP-së u ka kaluar mandati dhe si i tillë nuk mund të ushtrojë funksionin dhe kompetencat e veta të parapara me Ligjin e prokurimit publik, gjë që nuk u miratua as sot në këtë seancë, çka do të thotë se do të rrjedhin pasoja në këtë drejtim edhe në të ardhmen.

Vazhdimi i kontratave publike sipas sistemit 1 + 1, që konsiderohet shkelje e Ligjit të prokurimit publik, prandaj kërkohet që të përfshihet edhe një nen, i cili nuk lejon vazhdimin e kontratave publike.

Po ashtu, sfida është edhe mos futja e operatorëve ekonomikë në listë të zezë. Operatorët ekonomikë, që nuk i kanë përmbushur kontratat edhe më tutje vazhdojnë të punojnë, pasi që nuk janë futur në listën e zezë. Po ashtu, si sfida janë edhe kapacitetet e kufizuara për të zbatuar obligimet, që kërkohen sipas ligjit, me theks të veçantë implementimin e prokurimit elektronik.

Shqetësimet e ngritura nga organizatat buxhetore ishin tenderët jonormalisht të ulët, përmirësimi i gabimeve aritmetike, kur është kërkuar të caktohet një kufi për pranimin e gabimeve aritmetikore, mungesa e të dhënave për çmimet për njësi që mund të publikohen çdo tre muaj dhe mund të përdoret si një mjet nga autoritetet kontraktuese. Përcaktimi i duhur i specifikave teknike nga njësitë kërkuuese pranë autoriteteve kontraktuese në përgjithësi të ndërlidhura, shqetësimet e ngritura nga operatorët ekonomikë janë edhe mungesa e përgjegjësisë së komisioneve vlerësuese.

Pas aktiviteteve të planifikuara, grupi punues ka hartuar rekomandimet të cilat janë që Ministria e Financave të zgjedhë drejtorin e Agjencisë Qendrore të Prokurimit, siç është paraparë me nenin 96 të Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës. Po ashtu, rekomandim nga Komisioni është që janë bërë shkelje të neneve 6, 7, 10, 27, 28, 59, 60, andaj kërkohen ndëshkime maksimale për të gjithë ata që shkelin këto nene dhe që shkelin në përgjithësi Ligjin e prokurimit publik.

Qeveria të propozojë dhe të emërohen nga Kuvendi anëtarët e Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, siç është paraparë me nenin 100, pasi që disa anëtarëve u ka kaluar mandati dhe si i tillë OSHP-ja është komplet jashtë funksionit tash e disa muaj dhe nuk mund të ushtrojë funksionin dhe kompetencat e veta të parapara me Ligjin e prokurimit publik.

Rekomandimi tjetër është të rishikohet neni 61, tenderët jonormalisht të ulët dhe Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik të nxjerrë akte nënligjore për rregullimin e çështjeve në lidhje me tenderët jonormalisht të ulët, pasi kjo po paraqet një rrezik të madh që mos të ekzekutohen kontratat apo edhe në kualitetin që nuk përputhet me kërkesat e autoriteteve kontraktuese.

Të rishikohet neni 59, pika 3 e Ligjit të prokurimit publik, të bëhet përmirësimi i gabimeve aritmetikore dhe të rregullohet që në hapje të tenderëve të lexohet çmimi për njësi, ose të nënshkruhen ofertat nga ofertuesit tjerë dhe varësisht prej madhësisë së ofertave, autoriteti kontraktues të vendosë se a do të lexojë çmimin për njësi apo të nënshkruajë oferta nga pjesëmarrësit.

Rekomandimi tjetër është që Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik të zhvillojë një bazë të të dhënave për çmimet referente dhe të publikohen çdo tremujor dhe të përdoren si një mjet nga autoritetet kontraktuese për përgatitjen e vlerësimeve të kostos së projekteve dhe vlerësimit të tenderëve.

Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik në lidhje me nenin 25 të zhvillojë aktivitete shtesë, që kapaciteti i zyrtarëve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese edhe më tej të avancohet për të siguruar rritjen dhe mbajtjen e nivelit të lartë kompetence në radhët e zyrtarëve të prokurimit dhe profesionistëve tjerë të prokurimit, për zbatimin e praktikave të shëndosha të prokurimit dhe për respektimin e këtij ligji.

Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik, interpretimet e dispozitave të Ligjit të prokurimit publik, të lëshuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik t'i

publikojë në ueb faqen e këtij Komisioni, siç kërkohet me nenin 87, paragrafi 2.14 të Ligjit të prokurimit publik.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik t'i rrisë monitorimet e aktiviteteve të prokurimit me qëllim të eliminimit të gabimeve të ngritjes së cilësisë së punës të autoriteteve kontraktuese dhe t'i identifikojë përparësitë dhe dobësitë në zbatimin e këtij ligji.

Në nenin 59 të përfshihet një paragraf i ri, ku të gjithë anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe menaxherët e kontratave të ngarkohen me përgjegjësi individuale me qëllim që t'i ushtrojnë detyrat e tyre në pajtim të plotë me këtë ligj.

Të përfshihet edhe një nen, i cili nuk lejon vazhdimin e kontratave publike, siç është paraparë me nenin 38, pika 2 për kontrata publike kornizë.

Në nenin 99, paragrafi 2, të rregullohet që një operator ekonomik të futet në listë të zezë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit edhe për përmbushje të parregullt të kontratave e jo vetëm për falsifikim të dokumenteve, siç përcaktohet në këtë paragraf.

Në nenin 118 të ulet tarifa për ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Rekomandim tjetër është të nxirren rregulla në lidhje me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese.

Qeveria të nxjerrë strategjinë dhe planin e veprimit për prokurimin publik në Kosovë.

Autoritetet kontraktuese të lejojnë pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e punës së komisioneve për vlerësimin e tenderëve.

Të harmonizohet neni 10 i Ligjit të prokurimit publik të Republikës së Kosovës me Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare.

Të plotësohet Ligji për prokurimin publik në Republikën e Kosovës me një nen të ri në lidhje me afatet kohore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumenteve, në lidhje me ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdoja fjalën!

SAFETE HADËRGJONAJ: Të plotësohet Ligji për prokurim publik në Republikën e Kosovës me një paragraf të ri te neni 36, ku çdo kontratë me vlerë të vogël, që vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe se 5 mijë euro, të publikohen në faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, si njoftime për kontratë.

Qeveria të marrë parasysh rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa gjatë ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës.

I nderuar zoti kryetar,

Këto janë rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të cilat janë miratuar unanimitisht në Komisionin për Buxhet. Nëse më lejoni, kisha për ta thënë edhe mendimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, për të mos e marrë fjalën edhe njëherë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin me rekomandime të miratuar nga Komisioni për Buxhet dhe i ka përkrahur në tërësi rekomandimet të cilat i ka dhënë ky komision dhe kërkon nga Qeveria që të respektohen rekomandimet e Komisionit për Buxhet. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, pasi që duhet të ndryshohen shumë nene, Komisioni mund ta marrë iniciativën për ndryshim dhe plotësim të ligjit.

Po shkojmë te kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht e them se është e vërtetë që raporti ka kaluar në mënyrë unanime në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Unë personalisht kam qenë anëtare e grupit punues dhe kam pasur shumë komente në raport. Ato komente janë marrë parasysh deri diku dhe më është dashur të votoj, në mënyrë që komentet e mia të merren parasysh.

Megjithatë, asnjëherë nuk bindem që nenet të cilat janë pengesë për zbatimin praktik të ligjit, të rekomandojë Komisioni që ato të rregullohen me akte nënligjore nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, sepse edhe ne që nuk jemi juristë e dimë që akti nënligjor ka fuqi më të ulët juridike, më të pakët se sa neni i një ligji dhe nuk mund të rekomandohet një gjë e tillë.

Mirëpo, është luajtur me fjalë të tilla nga anëtarët e pozitës, për arsye se ne kemi kërkuar që amendamenti i Ligjit të prokurimit që ka ardhur javën e kaluar në Kuvend, t'i marrë parasysh edhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, në mënyrë që të plotësohet dhe të ndryshohet, do të thotë të merren parasysh edhe këto rekomandime.

Për të mos i marrë parasysh këto dhe për të bërë atë amendamentimin e famshëm, që biseduam javën e kaluar, është thënë, është luajtur me fjalë, që këto të rregullohen me akte nënligjore, gjë që nuk mund të ndodhë kjo në praktikë.

Tani, të nderuar kolegë deputetë, ne e dimë të gjithë se prokurimi publik është fusha më problematike, është vrima e zezë, është burimi i pasurimit të paligjshëm të dhjetëra e qindra zyrtarëve, të cilët pikërisht përmes shpenzimit të 900 milionëve të buxhetit të varfër të Kosovës, përmes këtij ligji ata përvetësojnë paratë publike. Derisa në Kosovë kemi një nivel kaq të lartë të korrupsionit, nuk ka zbatim të ligjit.

Institucionet e thirrura për ta luftuar korrupsionin dhe për ta zbatuar këtë ligj kanë dështuar, totalisht. Unë personalisht si anëtare e grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk kam qenë aspak e kënaqur me punën që e keni bërë në terren.

U tha edhe më herët, se kemi takuar rregullatorë, kemi takuar agjenci të pavarura, autoritete kontraktuese të nivelit qendror dhe lokal, që janë këto organizata buxhetore dhe gjithashtu kemi takuar operatorë komikë. Dhe, në mënyrë indirekte i kemi intervistuar të gjithë një nga një dhe kemi dashur të gjejmë përgjigje në pyetjen se a shkelet Ligji i prokurimit?

Nuk e di a befasohet dikush, por të gjithë na kanë thënë se e zbatojnë ligjin, e pritshme kjo, apo jo.

Të gjeturat tona janë të limituara, sepse metodologjia ishte e tillë. Unë kam propozuar që të hyjmë më në detaje. Për shembull, para disa javësh ne e kemi pasur një raport, për zbatimin e Ligjit të prokurimit nga institucionet e sigurisë nga Komisioni për Siguri. Dhe, mua më ka pëlqyer metodologjia e tyre, sepse ata kanë shkuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, kanë marrë lëndë, të cilat kanë bërë ankesa, operatorët ekonomikë që kanë bërë ankesa, i kanë marrë lëndët e tyre dhe i kanë shqyrtuar dhe në të gjitha ato lëndë ata kanë gjetur shkelje. Mirëpo, ne kemi dashur një metodë, kemi zgjedhur si Komision një metodë më sipërfaqësore, sepse sigurisht që kemi dashur ta kemi edhe një rezultat të garantuar, ashtu siç u tha se ligji kinse paska gjetur zbatueshmëri, gjë që nuk është e vërtetë.

Ne i kemi intervistuar njerëzit, i kemi pyetur: “A po e shkelni ligjin dhe ata kanë thënë Jo.” Kjo ka qenë puna jonë dhe këto janë rekomandimet e komisionit dhe të gjeturat e komisionit.

Unë besoj që zbatueshmëria e ligjeve nga anëtarët e Kuvendit nuk mund të matet, nëse pyeten përgjegjësit e zbatimit të ligjit, se a e shkelni ligjin? Ne duhet të gjejmë metoda më të sofistikuara, që të mund ta matim ligjin dhe të dalim këtu e të themi para qytetarëve të Kosovës, që shkelet apo jo ligji.

Në bazë të punës, edhe ashtu sipërfaqësore, ne kemi gjetur se Ligji i prokurimit është më i mirë se sa implementimi i tij në praktikë. Megjithatë, janë disa nene të cilat kërkojnë intervenim të menjëhershëm. Për shembull, neni 61 me tenderët jonormalisht të ultë, ku operatorët, autoritetet kontraktuese e kanë problem, sepse nëse kriteret për të dhënë një tender janë çmimi më i ulët, atëherë po na del që këto firma, kompani të cilat nuk kanë asnjë lloj mundësie për të zbatuar një projekt, po e fitojnë projektin dhe kështu po zvarritet puna. Këtu nuk po mund të implementohen projektet dhe kështu nuk po kemi një zbatueshmëri të projekteve kapitale, po kemi bartje të tyre nga viti në vit.

Gjithashtu, është shumë problematik neni 59.3, i cili u lejon operatorëve ekonomikë që të rregullojnë gabime aritmetikore.

Ju lutem shumë, tash nuk ka kompani e cila nuk përdor kompjuterë, të dhënat mund të rregullohen në EXEL dhe asnjë autoritet kontraktues nuk duhet të pranojë oferta me gabime aritmetikore.

Autoritetet kontraktuese, njerëzit që merren me prokurim, na kanë thënë që kur ky nen nuk ka qenë në fuqi, ne nuk kemi pasur gabime, por tash gabimet janë të qëllimshme,

sepse dikush oferton me një çmim dhe më pas në procedurë e sipër vjen e thotë se ka munguar një zero. Imagjinoni, gjëra të tilla janë të lejueshme me ligj.

Dhe, kjo nuk rregullohet me akt nënligjor, siç u rekomandua nga kryetarja e Komisionit, por këtu duhet të ndryshohet neni, sepse akti nënligjor nuk mund të thotë që neni nuk është në fuqi.

Problem tjetër është mungesa e çmimeve referente që ne kemi rekomanduar që të bëhet, mirëpo kjo kërkon një strategji dhe një veprim të qartë nga ana e Qeverisë. Mandej është problem në vete specifikacionet teknike. Problem i natyrës shumë të madhe, që ndërlikohet drejtpërdrejt me korrupsionin, është menaxhimi i kontratave.

Këtu janë keqpërdorimet më të mëdha. Ne duhet t'i bëjmë njerëzit përgjegjës me ligj, përgjegjësia të jetë individuale, sepse këtu është manipulimi më i madh me parane publike. Duhet patjetër të cek që ne kemi takuar edhe operatorët ekonomikë. Me insistimin shumë të madh të anëtarëve nga opozita në grupin punues, ne kemi thirrur një dëgjim publik me operatorët ekonomikë dhe kemi zgjedhur nga lista e ankuesve në Organin Shqyrtues të Prokurimit. I kemi thirrur 15 biznese dhe imagjinoni, na janë përgjigjur vetëm 3.

Këta tre përfaqësues të bizneseve nuk kanë pasur guximin, që të shprehen për pakënaqësitë që i kanë pasur në proceset tenderuese në Komisionin tonë. U është censuruar fjala, u është ndërprerë disa herë dhe nuk kemi nxjerrë asgjë prej saj. Kanë shkuar deri në atë masë sa që ata na kanë pyetur: “Nëse ju doni ta dini se cilat janë shkeljet që na janë bërë, ejani me neve pimë kafe në restorant dhe ju tregojmë, se këto gjëra nuk fliten në Parlament.”

Imagjinoni, çfarë besimi kanë përfaqësuesit e bizneseve, pronarët e bizneseve në Parlamentin e Kosovës dhe në deputetët e Parlamentit të Kosovës.

Shoqëria civile, edhe pse nuk kemi takuar shumë prej tyre, vetëm KDI-në, kërkon më shumë transparencë. Ata kërkojnë që t'u lejohej monitorimi i Komisionit që bën vlerësimin e ofertave, megjithëse, këtë disa ministri dhe autoritete kontraktuese e lejojnë, kurse disa të tjera nuk e lejojnë, ata kërkojnë që t'u lejohej me ligj, që procesi të jetë i monitoruar nga përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Gjithashtu, është e nevojshme që me ligj të kërkohej që operatorët ekonomikë të papërgjegjshëm, u tha edhe në rekomandim, të futen në listën e zezë. Nëse dikush nuk i ka përmbushur kushtet e kontratës, atij të mos i jepet mundësia që prapë të konkurrojë dhe prapë të fitojë një tender dhe të marrë para nga Buxheti i Kosovës.

Duhet të bëhen përparime sa më shumë që të jetë e mundur në prokurimin elektronik, sepse praktikat në vendet e rajonit kanë treguar që prokurimi elektronik kap më pak hapësirë që të bëhet korrupsion dhe keqpërdorim i parasë.

Është rekomanduar në raport, gjithashtu, që një pjesë të madhe të prokurimit ta kryejë Agjencia Qendrore e Prokurimit, do të thotë të kemi një prokurim të centralizuar. Mirëpo, në formën çfarë po funksionon shteti sot, ne nuk garantohej se nëse Agjencia

Qendrore e Privatizimit bën prokurime për mallra dhe shërbime të ndryshme, që shfrytëzohen prej shumë organizatave buxhetore, ata i marrin me çmime më të lira. Dhe, nëse kjo nuk ndodh, atëherë ne vetëm i rrezikojmë ndërmarrjet. 99% e ndërmarrjeve në Kosovë janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Nëse kemi një centralizim të tillë nga Agjencia e Prokurimit, ne rrezikojmë që ta monopolizojmë tregun për disa produkte dhe shërbime dhe kështu t'i heqim nga loja, nga tregu, një numër të madh të kompanive të vogla.

Problem paraqesin edhe kontratat aneksore. Edhe kjo duhet të rregullohet me ligj, sepse shpeshherë ofertuesit nuk përfshijnë disa finesa të projekteve dhe mandej na paraqiten me kërkesa dhe kontrata aneksore. Gjithashtu është shumë problematike vazhdimi i 1+1 kontratave. Ligji e precizon se si mund të vazhdohet kontrata kornizë, mirëpo ligji nuk e thotë qartazi se kontratat nuk duhet të vazhdohen. Dhe, kjo po ndodh me të madhe nga autoritetet kontraktuese ku ata në kundërshtim, meqenëse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoje edhe një minutë.

HYKMETE BAJRAMI: Po vazhdohen kontratat në formën 1+1 dhe kjo është komplet në kundërshtim me ligjin, sepse është papërgjegjshmëri e operatorit ekonomik, nëse ai nuk e përmbush punën e paraparë me kontratë dhe atij duhet t'i shkëputet kontrata dhe jo t'i vazhdohet kontrata.

Ju mund t'i votoni rekomandimet. Besoj që nuk ka asgjë të keqe, mirëpo asnjë prej nesh nuk mund të pajtohem që ligji të rregullohet me akte nënligjore. Dhe, unë jam shumë e sigurt që edhe votimi i këtyre rekomandimeve dhe i këtij raporti nuk do ta ndryshojë gjendjen edhe ashtu shumë të keqe në terren. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të "Vetëvendosjes", deputetja Albana Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

E nderuar ministër,

Në Komisionin për Buxhet dhe Financa kam qenë anëtare e grupit punues të monitorimit të Ligjit për prokurimin publik dhe gjatë monitorimit që e kemi bërë në terren të këtij ligji, kemi parë që Ligji i prokurimit publik, sfidë serioze e ka implementimin e tij në praktikë, pra parregullsi të shumta që e përcjellin zbatimin e këtij ligji.

Gjatë takimit me operatorët ekonomikë kemi hasur në ankesa të shumta prej tyre, sa i përket mënyrës së dhënies së tenderëve, favorizimeve që bëhen me rastin e dhënies së tyre, kriteret e dhënies së kontratës nuk përcaktohen sipas natyrës së prokurimit dhe nuk janë të qarta.

Për shkak të parregullsive të shumta, operatorët ekonomikë dërgojnë ankesë në OSHP, mirëpo tarifa prej 500 eurove në rast të ushtrimit të së drejtës së ankesës është e

papërballueshme për operatorët ekonomikë. Prandaj, edhe si grup punues kemi rekomanduar që të zvogëlohet kjo shumë.

Gjithashtu, konsiderojmë që është e rëndësishme që të lejohet pjesëmarrja e organizatave të Shoqërisë Civile në monitorimin e punës së Komisionit për vlerësimin e tenderëve.

Kërkesa ka pasur edhe për zhvillimin e prokurimit elektronik. Prokurimi elektronik mund ta bëjë procesin e prokurimit më të thjeshtë, kontratat mund të konkludohen më shpejt dhe shpenzimet e operimit mund të ulen.

Rritja e transparencës dhe qasja më e lehtë në tenderë përmes prokurimit elektronik, sjell pjesëmarrje më të lartë të tenderuesve e cila çon në çmime më të ulëta dhe në rezultate më të mira.

Mundësitë e mëdha për mashtrime dhe korrupsion që janë ngritur si shqetësime gjatë monitorimit të ligjit, na sjellin në përfundim se nuk ka pasur aspak vullnet nga institucionet qeveritare që të krijojnë një strategji për luftimin e korrupsionit.

Kjo na çon në dy përfundime, ose nuk janë të interesuar ta luftojnë korrupsionin ose vetë janë të përfshirë në të. Pra, siç e thash sfida kryesore është monitorimi i këtij ligji në praktikë, luftimi i korrupsionit i cili është në përmasa alarmante dhe gjithashtu më duhet ta cek, u cek edhe nga parafolësja që në grupin punues për monitorimin e këtij ligji kur i kemi thirrur në dëgjim publik operatorët ekonomikë që të na flasin për Ligjin për prokurimin publik dhe sa ata kanë hapësirë edhe qasje, edhe sa u ofrohet mundësia që të jenë të barabartë në prokurim publik, atëherë ata nuk janë lejuar të flasin, më konkretisht nuk janë lejuar të flasin nga një deputet i Partisë Demokratike, i cili disa herë ia ka ndërprerë fjalën operatorëve ekonomik, të cilët kanë qenë aty në grupin punues.

Realisht, ai takim ka qenë pothuajse joproduktiv për shkak se ne nuk kemi mundur ta marrim asnjë informacion edhe presioni i tillë që u bëhet operatorëve ekonomikë që të flasin të vërtetën edhe të tregojnë për korrupsionin që po ndodh, që është prezent edhe të luftohet ai, mendoj që është i papranueshëm për shkak se deputetët janë ata, deputetë edhe të gjithë personat politikë janë ata që në radhë të parë duhet ta luftojnë korrupsionin, mirëpo nga ai gjest që e pamë në Parlamentin e Kosovës, më konkretisht në Komisionin për Buxhet dhe Financa na bie në një përfundim se një pjesë e politikanëve jo vetëm që nuk e luftojnë korrupsionin, por një sjellje e tij na bien në përfundim të mendojmë se janë pikërisht një pjesë e këtyre që janë të korruptuar edhe janë ata që e shantazhojnë edhe operatorët ekonomikë, e ndoshta jo vetëm ata. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!
Kolegë deputetë,

Pas gjithë që u tha nga tri zonjat këtu për monitorimin e këtij ligji dhe pas punës që ka bërë grupi punues edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i përkrah rekomandimet, të cilat kanë dal dhe janë votuar nga anëtarët e Komisionit të Buxhetit

dhe nëse dëshirohet që të ndryshohet ai ligj dhe të përmirësohet mund të merren rekomandimet dhe të intervenohen në nene të atij ligjit dhe të jetë ai ligj më funksional.

Unë shumë shkurt do të them që fusha që them që është ka mundësi të bëhen keqpërdorimet më të mëdha është fusha e ndërtimitarisë dhe fusha e shëndetësisë. Këto dy fusha ka mundësi që të bëhen të gjitha ato të këqijat që sot po përflitet, se janë dy fusha që harxhojnë më tepër dhe ka tenderime më tepër.

Pra, janë fusha të cilat mund të bëhen këto malverzime. Unë besoj që hallkat që e zbatojnë Ligjin e prokurimit duhet të jenë shumë më efikase nga ai që e cakton tenderin e deri te mbikëqyrja. Edhe sidomos te mbikëqyrësi i fundit, për arsye se ai duhet me përpikëri të shikojë se a është realizuar ai projekt ashtu siç është paraparë në letra dhe i projektuar?

Shpeshherë nga operatorët kryhet puna ndryshe se sa që është e përshkruar në prokurim. Këto janë ato të meta të këtij ligji të cilët duhet institucionet të intervenojnë dhe të jetë një ligj shumë më i përsosur, një ligj që në praktikë duhet të zbatohet me përpikëri.

Për Grupin e Aleancës është që Qeveria e Kosovës sa më shpejt të ndikojë që prokurimi të bëhet në mënyrë elektronike dhe i centralizuar për arsye se do të mbyllet disa vrima të zeza në të cilët po flitet që kjo fushë është ndër fushat më të korruptuara. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Fillimisht po i cek disa nga të gjeturat e grupit punues gjatë monitorimit të Ligjit për prokurimin publik. Për të siguruar rritjen dhe mbajtjen e një niveli të lartë, kompetencën, në radhët e zyrtarëve të prokurimit për zbatimin e praktikave të shëndosha të prokurimit dhe për respektim të ligjit sipas raportit të KRPP-së mbi kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2012, janë dhënë 71 interpretime përmes arkivit të KRPP-së dhe 593 interpretime nuk janë publikuar në ueb faqen e KRPP-së, sipas kërkesës së nenit 87 paragrafi 2.1ii ku publikimi do të lehtësonte dhe ndihmonte autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji.

Gjatë vitit 2012, Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje në kuadër të KRPP-së ka monitoruar 24 autoritete kontraktuese, nga 166. KRPP patjetër duhet të rrisë monitorimet me qëllim të eliminimit të gabimeve dhe ngritjen e cilësisë së punës të autoriteteve kontraktuese dhe të identifikojnë përparësitë dhe dobësitë në zbatimin e këtij ligji.

KRPP ka kapacitete të kufizuara për të zbatuar obligimet që kërkohen sipas ligjit e me theks të veçantë në implementimin e prokurimit elektronik.

Agjencia Qendrore e Prokurimit nuk ushtron funksionet kryesore që janë të caktuara me këtë ligj, përkatësisht neni 95, vlerat e centralizuara dhe nëse marrim parasysh kontrollin efektiv buxhetor, efikasitetin, kursimet, klimën e tanishme ekonomike dhe roli në rritje i prokurimit në adresimin e çështjeve qeveritare, atëherë nevoja për centralizim është në

rritje dhe mos ushtrimi i funksionit themelor të AQP-së për blerje të centralizuar siç është identifikimi i artikujve të përdorimit të zakonshëm, të cilët mund të blihen në mënyrën më efikase përmes aplikimit të procedurës së përbashkët.

Agjencia Qendrore e Prokurimit udhëhiqet nga ushtrues i detyrës së drejtorit. Shkeljet e shpeshta të neneve 6, 7, 10, 27, 28, 59 dhe 60 përkatësisht economiciteti dhe efikasiteti, barazia në trajtim, mjetet për promovimin e transparencës, dosja e tenderit, specifikimet teknike, ekzhiminimi, vlerësimet dhe krahasimi i tenderëve, si dhe kriteret për dhënien e kontratës, janë evidentuar si shkelje më të shpeshta gjatë shqyrtimit të ankesave nga ana e organit shqyrtues të prokurimit.

Disa anëtarëve të bordit të organit shqyrtues të prokurimit, iu ka skaduar mandati. Kështu që OSHP nuk do të mund të ushtrojë funksione dhe kompetencat e veta të parapara me këtë ligj. Pastaj, ekzekutimi jo efektiv i kontratave siç janë: vonesat, mos përmbushja e kontratës, ndryshimi i specifikacioneve të vendosura, zgjedhja e ofertuesve të gabuar etj. vijnë si rezultat i caktimit të personave jo kompetentë në detyrën e menaxherit të kontratës, ku edhe të cilët marrin pjesë në komisionet e vlerësimit të tenderëve e në raste të tilla kjo konsiderohet shkelje e ligjit.

Shumë prokurime kryhen në fund të vitit ku shumica e tyre janë vlera të paplanifikuara apo thjesht blihen veç për ta shpenzuar buxhetin, gjë që rrit rrezikun për gabimet e ndryshme dhe lëshimet nga zyrtarët e prokurimit, duke marrë parasysh presionin e kohës dhe vëllimin e punës.

Kriteret e kërkuara nga autoriteti kontraktues shpeshherë janë të pa definuara qartë, shumë autoritete kontraktuese i komplikojnë kërkesat e tyre me dokumentet që nuk janë aq relevante, gjë që krijon konfuzion rreth asaj se çka duhet të dorëzojë ofertuesi.

Një dukuri tjetër, qasja jo profesionale e ofertuesve ku ndodh që si pasojë e mungesës së njohurive dhe trajnimeve plotësohen gabimisht dokumentet e kërkuara dhe kjo qon në eliminimin e tyre nga garat dhe zvogëlon konkurrencën.

Neni 118 është pengesë për operatorët ekonomikë gjatë ushtrimit të drejtës së ankesës, prandaj kërkohet që tarifa për ankesa në OSHP në vlera prej 500 euro të zvogëlohet. Ligji për prokurimin publik në përgjithësi pasqyron në mënyrë adekuate parimet kryesore të një sistemi të mirë të prokurimit, është në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare, megjithatë sfidë mbetet zbatimi i tij.

Nga grupi punues janë nxjerr rekomandimet, të cilat ne si Grup Parlamentar i përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të SLS, Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, predsedniče! I poslanička grupa Samostalne Liberalne Stranke je razmotrila izveštaj Komisije za budet i financije u vezi... zakona o javnim nabavkama i mi čemo ovaj izveštaj podržati. Hvala!

KRYETARI: Në emër të “Zajednička Budućnost”, Goran Marinkoviqi, kryetar i Grupit.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala uvaženi predsjedniče!

I poslanička grupa “Zajednička Budućnost” podržace usvajanje izveštaja komisije.

KRYETARI: Faleminderit! Po shkojmë radhën e deputetëve, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit! I nderuari kryetar!

Përsëndetje për ministrin,

Duke marrë parasysh se Ligji për prokurimin publik në Republikën e Kosovës është ligji më i rëndësishëm pas Ligjit të buxhetit dhe me sa e shoh unë këtu në paraqitjen e deputetëve janë vetëm 3 deputetë, do të thotë se nuk është fort me rëndësi si shpenzohet buxheti dhe si zbatohet Ligji i prokurimit publik.

Nuk kisha për t’u befasuar fort prej deputetëve të pozitës as nga ata të opozitës. Duke marrë parasysh se x raste gjatë raportit të auditorëve ne kemi mundësi të shohim se sa është zbatuar Ligji i prokurimit publik shohim rekomandimet të cilat i jep auditori dhe rekomandimet të cilat akoma vlejnë edhe për linjat buxhetore të ministrive, të komunave, të agjencive të pavarura dhe shohim mangësi edhe në vetë Agjencinë e Prokurimit Publik, unë falënderoj Komisionin Parlamentar për Buxhet dhe Financa që ka marrë të monitorojë dhe të mbikëqyrë Ligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Në rast se i shohim rekomandimet të cilat i ka nxjerr Komisioni për Buxhet dhe Financa, mund të themi se janë rekomandime ndoshta këta kanë pasur mundësi të nxjerrin akoma rekomandime më shumë se u tha edhe nga parafolësit se operatorët ekonomikë nuk guxojnë të flasin. Ata nuk guxojnë të flasin se kanë marrëveshje përjashta dhe kur vijnë në dëgjim publik, për atë arsye nuk flasin.

Në pikën 6, Komisioni Parlamentar nxjerr, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të zhvillojë një bazë të të dhënave mbi çmimin referent dhe të publikohet në çdo tre muaj. Ne e patëm Ligjin për prokurim publik dhe u pa që aty ishte një plotësim-ndryshim i vogël, mirëpo në efekt, Ligji i prokurimit publik duhet të ndryshojë, se vetë KRPP-ja, OSHP-ja dhe Agjencia e Prokurimit kanë defekte në zbatueshmërinë e ligjit.

Dhe, në rast se kthehem vetëm te rekomandimi nr.2, shihen shkelje të nenit 6, 7, 10, 27, 28, 59, 60, unë nuk e di atëherë çka presin ata njerëz aty që punojnë.

Në rast se shkojmë te rekomandimi 13, të ulen tarifat për ankesa në Organin shqyrtues të prokurimit edhe me tarifa të larta aty ka ankesa apo me sa po më duket kurrkush nuk merret me ato ankesa në efekt të shohë çka po ndodh në prapaskenë për të ardhur puna deri te ankesat.

Të nxirren rregulla në lidhje me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese. Besoj që të gjithë deputetët e Kuvendit janë të mendimit që kjo të ndodhë sa më shpejtë.

Diç që të bie në sy në këto rekomandime është të harmonizohet neni 10 i Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës me Ligjin për qasjen në dokumentet publike, gjë që duhet të ndodhë në një kohë sa më të shkurtër. Në efekt duhet të themi, duhet të falënderohet Komisioni Parlamentar për punën që e ka bërë, mirëpo me sa po më duket nuk është interesi shumë i madh të shihet çështja e zbatueshmërisë së ligjit më të rëndësishëm pas Ligjit të buxhetit në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Pajtohem edhe unë plotësisht edhe me Grupin parlamentar që jam në mbështetje të pikave të rekomandimeve që dalin, që i ka nxjerr Komisioni për Buxhet dhe Financa, personalisht mendoj po ashtu se është për ta lavdëruar një nismë e Komisionit për monitorimin e zbatimit të këtij ligji që konsiderohet që është ndër më delikatët, ndoshta institucionet që zbatojnë këtë ligj po ashtu.

Jo rastësisht në raportet e progresit të të gjithave me radhë që vijnë nga Komisioni Evropian për punën e institucioneve në Kosovë, përmendet dukuria si korrupsioni dhe veçanërisht këto mekanizma të paktën është përceptsi që janë më të ndjeshme, më të atakuarat për tu bërë ky vlerësim, unë e mora fjalën vetëm për disa çështje që janë më shumë teknike, ndoshta është krejt vonë tash meqenëse i ka radhitur edhe pikat, edhe rekomandimet.

Në të paktën dy pika përmendet “të plotësohet Ligji për prokurimin publik” unë mendoj që një prej pikave është dashur të thuhet, decidivisht të fillojë procedura ose iniciativa për plotësim-ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik dhe pastaj të radhiten pikat disa prej të cilave janë esencialisht të rëndësishme për t’u ndryshuar.

Ndërsa, po ashtu te pika e 14 është të nxirren rregulla në lidhje me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese. Unë mendoj që është decidivisht duhet të thuhet “të fillojë procedura ose të aplikohen metoda të prokurimit elektronik” dhe nëse është kjo çështje që duhet të hyjë në ligj, të potencohet atëherë është çështje e plotësim ndryshimit të ligjit.

Çështja e prokurimit elektronik përmendet si një prej metodave që mund ta parandalojë korrupsionin dhe mendohet që në disa vende i ka shpëtuar me “fytirë” si thuhet disa shtete, aplikimi i prokurimit elektronik. Dhe po ashtu më lejoni të komentoj edhe diçka që ka të bëjë me mënyrat se si e bëjmë monitorimin e zbatimit të ligjit.

Ne nuk kemi as gjykatës, as prokurorë, as hetues, ne duhet të kontaktojmë me institucionet, duhet të bazohemi me ato çka dëgjojmë, me ato letrat që prodhojnë ato institucione. Ne duhet t’i trajtojmë më shumë në rastin e këtij ligji të dhënat ose statistikatat nga gjykatat, nga auditori i përgjithshëm dhe agjencitë e auditimit dhe po ashtu të bazohemi në perceptimin publik që rol të veçantë kanë mediet ose dokumentet që nxjerrin mediet, pra që bëhen publike.

Është e radhës t'i ftojmë nga këtu të gjitha institucionet dhe njësitë buxhetore ose njësitë shpenzuese të buxhetit që të punojnë sa më shumë në zbatimin e këtij ligji, sa më mirë në zbatimin e këtij ligji, sepse deri më tash konsiderohet si ligj shumë problematik zbatimi i të cilit ka qenë sfidë e madhe. Pra, duhet të ftohen që të zbatohet ky ligj dhe të fillojë procedura e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari ministër,

Gjatë analizimit të hollësishëm të këtij raporti dhe statistikave përmbajtjesore të tij shihet që pothuajse në secilin autoritet kontraktues publik, përfshirë qeverisjen qendrore dhe po ashtu qeverisjen lokale, si dhe agjencitë e pavarura, pretendohet të ketë pasur shkelje të Ligjit të prokurimit publik gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre prokuruese.

Edhe pse ky raport tregon një situatë progresive në zbatueshmërinë e Ligjit të prokurimit nëpër autoritetet kontraktuese publike në Kosovë, por duke u bazuar në raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare mbi monitorimin e sistemit të prokurimit publik gjithmonë thuhet e kundërta. Sot lirisht mund të themi se njëra ndër sfidat më të mëdha në të gjitha autoritetet kontraktuese në Kosovë, duke përfshirë edhe OSHP-në janë ndërhyrjet e vazhdueshme nga politika dhe nga grupet e interesit, të cilët përveçse rezultojnë me afëra të ndryshme korruptive dhe shpenzim jo racional të buxhetit publik, ato edhe po krijojnë deformime profesionale të stafit, konkretisht shërbyesve civilë të cilët janë të autorizuar dhe kompetentë të ushtrojnë këtë fushë veprimtari.

Kjo rezulton që në autoritet kontraktuese në Kosovë është duke pasur shkelje të vazhdueshme të Ligjit të prokurimit edhe pse tanimë Kosova ka në zbatim kornizën ligjore më të avancuar, të paktën kështu thuhet nga Raporti i Progresit, në rajon përfshirë këtu edhe Ligjin aktual të prokurimit publik nr. 04/L-042, udhëzimet operative, administrative, si dhe legjislacionin sekondar që do të thotë që ndërhyrjet politike dhe interferimet në këto procese po e dëmtojnë jashtëzakonisht imazhin e të gjithë sistemit të prokurimit publik në Kosovë, pra në përgjithësi.

Prandaj, unë konsideroj që Ligji i prokurimit, do të thotë është një ligj i avancuar dhe rekomandimet të cilat kanë dalë nga ky Komision, të cilat i kanë nxjerr nuk është në pyetje se këto rekomandime nuk janë që qëlluara, por unë konsideroj që këto rekomandime do të mbesin në letër dhe do të mbesin të pa implementuara. Pra, problemi nuk është te Ligji i prokurimit, por problemi është te organizatat ose qoftë nga niveli qendror apo nga niveli lokal, si dhe agjencitë e pavarura që nuk po e zbatojnë Ligjin e prokurimit, ligj i cili është shumë i rëndësishëm dhe ligj i cili ruan dhe mbron buxhetin publik.

Prandaj, konsideroj që këto rekomandime të cilat janë dalë nga ky mision duhet urgjentisht do të thotë të shqyrtohet nga sponzorizuesi i këtij ligji që ligji ndoshta duhet të pësojë edhe plotësim – ndryshime por konsideroj që këto rekomandime të paktën duhet të implementohen, sepse me plotësimin edhe me futjen e këtyre rekomandimeve sistemi i prokurimit në Kosovë do të avancohet akoma më tepër. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Amir Ahmeti.

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryetar!

E dëgjuam edhe kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe nga deputetët ekonomistë profesionistë.

Unë desha t'i jap disa vërejte nga aspekti juridik. Me këtë rast ne po konkuldojmë se nuk kemi mungesë të ligjeve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, por problemi qëndron në mos zbatueshmërinë e ligjit. Këtu po argumentohet se ne nuk kemi nevojë për të bërë task-forca kundër korrupsionit nga Presidenca, nga Qeveria, nga Kuvendi, por thjeshtë të kërkojmë që të zbatohet Ligji aktual.

Unë përshëndes Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe për mbikëqyrjen e këtij ligji, por i kam disa vërejtje dhe ato janë duke filluar prej rekomandimit të parë. Rekomandimi i parë thotë: “Ministria e Financave të zgjedhë drejtorin e Agjencisë Qendrore të Prokurimit, siç është paraparë në nenin 96 të Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës”. Unë mendoj se kjo është përsëritje e ligjit, sepse është i panevojshëm, nuk kemi nevojë që ne të përsëritim kërkesën për implementimin e ligjit, thjesht neni ekziston, ligji ekziston atëherë ministria duhet ta zbatojë këtë ligj.

Po ashtu kemi përsëritje të rekomandimeve në raport me ligjin, ku thotë: “Qeveria të propozojë dhe të emërohen nga Kuvendi, anëtarët e bordit të OSHP-së” siç është paraparë me nenin 100. Domethënë nuk kemi nevojë ta përkujtojmë, sepse ligji ekziston edhe ata duhet vetëm ta vazhdojnë për t' i zgjedhur anëtarët, sepse anëtarëve iu ka kaluar mandati.

I njëjti element është edhe të rekomandimi i tetë është përsëritje, konsideroj për ligjin sepse thotë: “Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik, interpretimet dispozitave të Ligjit të prokurimit publik- thotë t' i publikojë në ueb faqen, siç është e paraparë në nenin 87 ose siç kërkohet prej nenit 87. Përderisa neni po ekzistua, atëherë vetëm ai duhet ta implementojë këtë dhe duhet ta publikojë në ueb faqe dhe s'ka nevojë ta përsërisë këtë.

Vërejtje tjetër tek rekomandimi 14, mendoj se qëndron një problem të adresimi i problematikës ku thotë: “të nxirren rregulla në lidhje me përdorimin e metodave të prokurimit elektronik nga autoritetet kontraktuese”, mendoj se këtu mungon se kujt i adresohemi.

I rekomandohet për të nxjerrë rregulla Ministria e Financave apo Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik, apo Kuvendi, kush ka për t' i nxjerrë këto rregulla.

Ndërsa, tek rekomandimi 16 vërejtja, ime është në fund të fjalisë ku thotë: “autoritetet kontraktuese të lejojnë pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin e punës së komisioneve për vlerësimin e tenderëve”. Mendoj se këtu duhet të shtohet: “bazuar në këtë ligj” ose “bazuar në këtë praktikë”, sepse nëse ne nuk i adresohemi se për çfarë arsye duhet lejuar organizatat, shoqërinë civile atëherë ai autoritet mund të mos e pranojë këtë. Përndryshe konsiderojmë se pajtohem me rekomandimet të cilat po kërkojnë që disa pjesë të ligjit, disa nene të ligjit që të përmirësohen ose që të shtohen anekse tjera në ligj, gjë që është shumë normale. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe, deputetja e fundit e lajmëruar për diskutim është Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Zonja Selmani më herët tha që opozita duhet të flasë më tepër rreth këtij raporti, sepse është e shqetësuar shumë me këtë raport, mirëpo do të doja t'i them që grupi punues në kuadër të Komisionit për Siguri, Punë të Brendshme dhe Forcë të Sigurisë, kur ka bërë një monitorim të tillë të Ligjit të prokurimit publik, gjegjësisht zbatueshmërisë së tij në institucionet e sigurisë, zonja Selmani e ka kontestuar ligjshmërinë e këtij Komisioni, sepse a ka të drejtë ta bëjë një monitorim të tillë dhe nuk e ka marrë mundin ta shqyrtojë apo ta trajtojë raportin për dallim prej këtij raporti, në atë raport kemi pasur lëndë të cilat kanë fituar si ofertues dhe në secilin prej tyre janë gjetur shkelje.

Prandaj, zonja Selmani më mirë do të ishte të flisnit edhe atëherë e sonte bëtë mirë që folët, mirëpo nuk është mirë të na sugjeroni.

KRYETARI: Replikë, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se atë raport edhe tash nuk e përkrah, të them shumë sinjerisht edhe pse është e drejtë e çdo Komisioni të bëjë raportime e ministrive adekuate, të cilat i kanë në Komision parlamentar, mirëpo e gjithë zhurma që po bëhet për korrupsion me raporte ndërkombëtare, unë kisha kërkuar që të shikohen së pari Ligji i prokurimit publik dhe Ligji për buxhetin e Kosovës, do të ishte më e mirë prej opozitës që vizavi me këto t'i japë rekomandimet.

KRYETARI: Vazhdojmë, nuk kemi të lajmëruar për diskutim, debat.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, prania fizike 75 deputetë, elektronike 94.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash raportin e Komisionit me rekomandime.

Konstatoj se me 66 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Pasi kemi kuorum i kthehem pikave që kemi për të votuar. Na kanë mbetur paraprakisht që të votojmë- Shqyrtimin e parë të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditorit të Republikës së Kosovës.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Konstatoj se me 68 vota për, 2 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 04/L-236 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

A do fjalën kryetari i Komisionit? Jo. Fjalën e ka deputetja Time Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Kryetar, në emër të Komisionit.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të neneve 57, 58 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në disa mbledhje të mbajtura ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria dhe në mbledhjen e mbajtur, më 22 nëntor 2003, vendos që Kuvendit t'i japë rekomandim.

Ftohen të gjithë deputetët ta përkrahin këtë projektligj dhe amendamentet e dhëna nga Komisioni Parlamentar.

KRYETARI: Mirë! Faleminderit! vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Amendamenti 7 është i propozuar nga Grupi Parlamentar SLS, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, me përkrahjen e Komisionit për Komunitete.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë tash!
Me 20 vota për, 45 kundër, 5 abstenime nuk miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë tekstin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.
Votojmë tash!

Të pranishëm janë 76 deputetë, prania fizike 73 deputetë

Konstatohet se me 69 vota për, 6 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për investimet e huaja

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për investimet e huaja dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në pajtim me nenin 57, 67, 68 të Rregullores të Kuvendit, në disa mbledhje të mbajtura e ka shqyrtuar këtë

projektligj dhe po ashtu në mbledhjen e datës 3 dhjetor ka vendosur që Kuvendit t’ia paraqesë këtë raport lidhur me Projektligjin për investimet e huaja.

Ka gjithsej 31 amendamente dhe ju ftoj që t’i aprovoni. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Shkojmë në procedurën e votimit.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 74 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 57 vota për, 7 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/L-220 për investimet e huaja.

Kalojmë në pikën e tetë meqenëse, pika e shtatë është shteruar si raport më herët.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike

Komisioni për Zhvillim Ekonomik ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri deputeti, Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit, e mbikëqyri zbatimin e Ligjit për ndërmarrjet publike të ndryshuar po ashtu në Ligjin numër 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, kur në mbledhjen e mbajtur më 3.12.2013, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin për miratim.

Dëshiroj ta falënderoj komisionin, e veçanërisht grupin punues që me durim ka kontaktuar të gjitha institucionet përkatëse, të nivelit lokal dhe qendror, përfaqësues të ndërmarrjeve të Qeverisë dhe ka pasur po ashtu debat publik, i ka shfrytëzuar të gjitha format e mundshme për të ardhur deri te rekomandimet sa më të mira dhe po ashtu ka pasur debat mjaft konstruktiv, edhe me palët e interesuara, po ashtu edhe brenda Komisionit dhe Grupit punues për arritjen e rekomandimeve të tilla.

Po ashtu, gjatë gjithë punës, komisioni e ka trajtuar si çështje të veçantë funksionimin e ndërmarrjeve publike dhe është shumë me rëndësi që në këtë kohë Kuvendi ta miratojë një dokument, i cili i përmban këto rekomandime.

Më lejoni që t'i lexoj rekomandimet para jush:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës të përfshijë në strategjinë legjislative për vitin 2014 plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike;
2. Qeveria t'u kthejë përgjigje komunave në lidhje me kërkesat e tyre për themelimin e ndërmarrjeve publike;

3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik ta fuqizojë rolin e njësisë për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike në aspektin e mbikëqyrjes së ndërmarrjeve publike, si dhe në aspektin e ngritjes së kapaciteteve administrative dhe financiare;
4. Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike, nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve duhet ta evaluojë, jo nga ndërmarrja publike, por nga ndonjë mekanizëm tjetër i kontraktuar nga jashtë ndërmarrjes;
5. Konkursët për drejtorë të ndërmarrjeve publike të jenë në përputhje me ligjin në fuqi dhe ta pasqyrojnë domosdoshmërinë e karakterit profesional të bordeve të ndërmarrjeve publike;
6. Bordet e ndërmarrjeve rajonale duhet të organizohen në atë mënyrë që t'u mundësohet komunave të atij rajoni të caktuar pjesëmarrja në bordet e këtyre ndërmarrjeve;
7. Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike në raportet e performansës së bordeve t'i rekomandojë Qeverisë të Kosovës që të marrë masat në bordet, të cilat nuk kanë performuar mirë dhe
8. Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike të hartojë udhëzime të qarta për bordet mbi mënyrën e kompensimit dhe rimbursimit të menaxhmentit të lartë të një ndërmarrjeje publike.

Këto kanë qenë rekomandimet që i kemi nxjerrë unanimisht anëtarët e komisionit, të propozuara nga Grupi punues, dhe ju ftoj që t'i mbështetni ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! përfaqësuesi i Qeverisë, e dëshiron fjalën?

MINISTRI FADIL ISMAILI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës.

Në esencë, nuk kam çfarë t'i shtoj këtij raporti. Me kënaqësi e lexova atë dhe vërejtjet e dhëna nga ky komision janë plotësisht të akceptueshme nga Ministria për Zhvillim Ekonomik. Janë gjithashtu edhe pika për të cilat edhe unë personalisht, edhe ekipi i njësisë për monitorim të ndërmarrjeve publike, i ka theksuar si probleme.

Ne, para se të vijmë në komision, veç e kemi prezantuar kërkesën, respektivisht në legjislacionin për vitin 2014 kemi paraparë edhe amendamentimin e Ligjit mbi ndërmarrjet publike dhe nëse ky amendamentim tejkalon 40% të ndërrimit substancial, atëherë pse jo edhe ligj i ri për ndërmarrjet publike. Nëse ka ndonjë pyetje, jam këtu. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Është radha e grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: I nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka trajtuar propozimin e bërë nga komisioni për Ligjin e monitorimit të ndërmarrjeve publike dhe është dakorduar plotësisht me rekomandimet të cilat janë nxjerrë nga ky komision dhe ftojme që të votohen si të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Zharku e ka fjalën

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Kolegë të nderuar,

I nderuar ministër,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin për monitorimin e zbatimit të Ligjit mbi ndërmarrjet publike. Natyrisht që kemi vërejtjet tona, por shumica e tyre janë përfshirë në rekomandimet tona, posaçërisht do të thoshim që është i rëndësishëm rekomandimi sa i përket një vlerësimi nga ana e jashtme e performansës së ndërmarrjeve publike për shkak se jemi të vetëdijshëm që rregullisht raportet që i marrim mbi funksionimin apo mbi performansën e ndërmarrjeve publike, marrim raporte të kryera, nga ato me të cilat vetëvlerësohet performansa e këtyre. Kështu që besojmë se është një rekomandim i mirë, i cili duhet të përfillet, apo duhet të respektohet struktura nga ndërmarrjet publike në angazhimin e kompanive të huaja, përkatësisht të jashtme për vlerësimin e asaj performanse.

Rekomandim tjetër i rëndësishëm besoj se është edhe zgjidhja e çështjes së pjesëmarrjes të komunave të vogla nëpër bordet e ndërmarrjeve publike. Megjithatë, aty ekziston një problem edhe nga ana praktike, për shkak se në komunat e mëdha, sa i përket përqindjes së aksioneve që i kanë komunat e mëdha, do të duhej të kishin më shumë anëtarë. Këtë problem e kemi pasur edhe në vitin 2009 me disa ndërmarrje publike regjionale për shkak se votat, apo thjesht përqindja e aksioneve duhet reflektuar edhe përqindjen e votës.

Kështu që te ndërmarrjet publike, komunat e mëdha kanë qenë të diskriminuara në aspektin e votës. E kanë pasur përqindjen, por nuk e kanë pasur votën për vendosjen e çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me ndërmarrjen publike. Kështu, duhet të gjendet një mekanizëm, i cili shpreh edhe përqindjen edhe në rastin e votimit, apo thjesht si mekanizëm të rriten bordet, por që të mos preket fuqia e një ndërmarrjeje sa i përket pjesëmarrjes aksionare të saj në ndërmarrjet publike.

Rekomandim tjetër me rëndësi është, që bie në kuadër të Ministrisë të Zhvillimit ekonomik, besoj se duhet përkrahja me e madhe për njësinë për monitorimin e ndërmarrjeve publike, në mënyrë që ato thjesht të afatësohen dhe të ngrihen kapacitetet e tyre në monitorimin e drejtpërdrejtë dhe real të këtyre ndërmarrjeve.

Është me rëndësi natyrisht që të kthehen të gjitha përgjigjet për ndërmarrjet komunale që kanë kërkuar të themelojnë ndërmarrje të reja publike. Me ligjin bazik nuk ka qenë i lejuar themelimi i ndërmarrjeve tjera publike, por tash me ndryshimet në ligj lejohet, kështu që është më se e domosdoshme që të kthehen ato përgjigje për ndërmarrjet e reja publike komunale. I dimë disa komuna, ndër to janë edhe Kaçaniku, Vitia dhe disa komuna tjera, posaçërisht sa u përket kompanive të ujërave.

Rekomandimi i fundit, së paku për ne me rëndësi, është ajo që me gjitha këto rekomandime, nëse nuk ashpërsohen sanksionet për anëtarë të bordeve në lidhje me performansën e tyre, besoj se pak do të kemi sukses në reformimin apo thjesht në rritjen e performansës së ndërmarrjeve publike. Kështu që rritja e një përgjegjësie për anëtarët e bordit për mosperformim apo thjesht për performim të dobët të ndërmarrjeve publike, do të duhej të ishte e lidhur drejtpërdrejt me vazhdimin e mandatit të tyre apo thjesht me shkarkimin e atyre anëtarëve të bordit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do t’i miratojë këto rekomandime që kanë dalë nga raporti i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit nga grupi punues, i cili pastaj është diskutuar dhe miratuar edhe në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, edhe pse konsiderojmë që në njëfarë mënyre ky raport e shmanget një çështje shumë të rëndësishme që ka të bëjë me Ligjin për ndërmarrjet publike, e ajo është neni, më saktësisht të them zbatimi i tij karshi tjetërsimit të ndërmarrjeve publike, apo tjetërsimit të një pjese të aksionit të ndërmarrjeve publike, meqë ne jemi më se të bindur si grup parlamentar që jo gjithëherë Qeveria e Republikës së Kosovës e ka zbatuar me përpikëri këtë ligj dhe sanksionet që ky ligj i parasheh karshi tjetërsimit të ndërmarrjeve publike, veçanërisht në rastin e privatizimit të KEDS-it, e po ashtu edhe në rastin e tentim privatizimit të Postës dhe të Telekomit të Kosovës, temë kjo e cila po vazhdon të sillet, të vijë vërdallë si një lloj fantazme në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me tentime të ndryshme të ndryshme të kontrabandës së një vendimi të tillë nëpërmjet buxhetit të vitit 2011, tash amendamentimit të buxhetit të vitit 2014, e kështu me radhë

Pra, kjo është një pikë, e cila është dashur të futet në raport dhe duhet edhe një herë t’i bëhet thirrje Qeverisë që domosdoshmërisht të punojë në përputhjen me ligjin në momentin kur merr vendim për privatizimin e ndonjë ndërmarrjeje publike, apo një pjese të ndërmarrjes publike.

Çështja e dytë që dua të ngre, e që lidhet me këtë, e veçanërisht lidhet me vitin 2014, pra me amendamentimin, me plotësim-ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme, e këtë e kemi ngritur edhe në komision në një diskutim që e kemi pasur me Ministrin, që të definohet qartë se kush e pronëson ndërmarrjen publike, për çka është ndërmarrja publike dhe çfarë natyre të pronës ka ajo, sepse, nëse lexohet me vëmendje Ligji për ndërmarrjet publike, aty disi përgjegjësia dhe pronësia për ndërmarrjet publike nuk është mjaft e qartë.

Pra, në disa aspekte Qeveria e Republikës së Kosovës paraqitet si pronare e ndërmarrjes publike, meqenëse i administron 100% të aksioneve të ndërmarrjes publike, por në disa raste tjera, veçanërisht karshi, ta zëmë tjetërsimit të ndërmarrjes publike, atëherë këtu futet në rol edhe Kuvendi, i cili duhet ta miratojë një vendim për tjetërsimin e ndërmarrjes publike dhe kjo në njëfarë mënyre thotë që pronësia mbi ndërmarrjet publike është vetë publiku dhe Kuvendi pastaj merret si një organ, i cili e reflekton, pra e përfaqëson vullnetin e publikut dhe si i tillë ai e ka të drejtën ekskluzive për të marrë

vendim për privatizimin e një ndërmarrjeje publike dhe në këtë drejtim kjo para duhet që të qartësohet.

Nëse Qeveria është pronare, atëherë Qeveria mund t'i marrë vendimet pa e pyetur Kuvendin, mirëpo nëse publiku është pronar i ndërmarrjes publike, atëherë vërtet duhet ta pyesin veten nëse e reflekton gjysma e Kuvendit apo shumica e thjeshtë e Kuvendit qëndrimin e publikut karshi një privatizimi të një ndërmarrjeje publike me rëndësi të veçantë, siç janë ato në Kosovë.

Pra, në këtë drejtim konsideroj që në plotësim-ndryshimin e ligjit, pasi të definohet se kush është pronar i ndërmarrjes publike, atëherë ligji edhe mënyra e tjetërsimit të ndërmarrjes publike duhet të jenë në përputhje me këtë dhe nëse është publiku, pra qytetarët e Kosovës, populli i Kosovës, në përgjithësi, pronar i ndërmarrjes publike, atëherë domosdoshmërisht duhet që tjetërsimi i ndërmarrjes publike bëhet me jo më pak se 2/3 e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse kjo vërtet mund të thuhet që është një përfaqësim më substancial i vullnetit të publikut karshi një çështjeje të caktuar.

Dhe, përgjithësisht, unë jam dakord që duhet të rritet roli ose fuqi e Kuvendit karshi edhe mbikëqyrjes së punës së ndërmarrjes publike, edhe mënyrës se si ato menaxhohen nga Qeveria, por me ligjin aktual roli i Kuvendit nuk është edhe aq i madh, përveç në këtë pikë për të cilën fola, në ndërkohë që do të duhet që Kuvendi ta kishte një rol më të madh, pra të gjenden mekanizma në plotësim-ndryshimin e ligjit, nëpërmjet të cilëve Kuvendit i hapet mundësia që të jetë më pjesëmarrës në menaxhimin e ndërmarrjeve publike.

Edhe një çështje për fund: unë e kam kërkuar këtë që ta futim edhe si rekomandim në këtë raport. Është çështja e rimbursimit të anëtarëve të bordit dhe të menaxhmentit të lartë të ndërmarrjeve publike. Mendoj se Qeveria e Kosovës duhet domosdoshmërisht t'i ketë kriteret e qarta për nivelin e pagave edhe për këta persona që shërbejnë në këto borde dhe në menaxhmentin e ndërmarrjeve publike dhe nëse këto janë, ekzistojnë si kriteret, besoj që i ka Qeveria si kriteret, atëherë këto duhet të jenë publike dhe mendoj që pagat e këtyre personave duhet po ashtu të jenë publike, sepse jam shumë ihtar i asaj se secila pagë publike që paguhet nga paratë publike të Kosovës, e paratë e ndërmarrjes publike janë para publike të Kosovës, ato duhet të jenë publike, në mënyrë që opinioni publik në Kosovë ta dijë edhe sa është niveli, edhe arsyetimin prapa këtij niveli të pagës.

Pra, nëse paga është e lartë për shkak të tregut, atëherë qytetarët e Kosovës duhet ta dinë se kjo është arsyeja pse ky person i caktuar, ose kjo pozitë e caktuar e ka pagën kaq të lartë dhe pastaj, nëse pranohet një pagë e lartë për një pozicion të caktuar për shkak të rrethanave në treg, atëherë duhet po ashtu publiku të bindet se personi, x-personi që është zgjedhur për atë pozicion, vërtet është ai i cili i përmbush kriteret profesionale, në mënyrë që ta arsyetojë pastaj pagën e vetë, sepse e kemi parë që ka natyrisht brengosje shumë të madhe të qytetarëve dhe diskutim shumë të madh për nivelin e pagave në përgjithësi, të menaxhmentit, edhe të Bordit të ndërmarrjeve publike, dhe jo rrallë qytetarët nuk janë të bindur, e dorën në zemër as unë si deputet nuk jam i bindur, se personat që emërohen aty nga Qeveria ose personat që emërohen në menaxhment nga Bordi, janë personat e duhur, ose ata që do ta meritonin, do ta arsyetonin një pagë kaq të lartë për punën që e bëjnë dhe për aftësitë profesionale që i kanë.

Pra, kjo është domosdoshmërisht një çështje që duhet t'i kërkohet Qeverisë nga Kuvendi dhe kështu të fuqizohet edhe roli i Kuvendit karshi vendimeve që merren për ndërmarrjet publike, sepse unë mendoj që ato domosdoshmërisht duhet të definohen si ndërmarrje në pronësi të publikut, të cilat për shkak të pozicionit dhe pushtetit ekzekutiv që e ka Qeveria do t'i menaxhojë ajo, por pronësia nuk është e Qeverisë, është e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, fjalën e ka fjalën e ka zoti Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryesues!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin për monitorimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe i mbështet rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SESLMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Duke marrë parasysh punën, e cila është e përshkruar në bazë të Rregullores së Kuvendit për komisionet parlamentare, e që në funksion të tyre është edhe monitorimi i zbatueshmërisë së ligjit, në këtë rast Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri mori në konsideratë zbatimin e Ligjit të ndërmarrjeve publike për arsye se e di mjaft mirë që ky Kuvend, një pjesë e këtyre deputetëve në legjislaturën e kaluar e dinë që ne e kemi miratuar Ligjin e ndërmarrjeve publike me pakon e presidentit Ahtisari.

Mirëpo, pas përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, ne kemi pasur plotësim-ndryshimin e këtij ligji dhe gjatë monitorimit të tij, prapëseprapë ka mangësi në zbatimin e tij dhe këto mangësi janë thënë në rekomandim. Është mirë që është i pranishëm ministri sot këtu, se kur të dalë një raport nga komisionet parlamentare për monitorimin e një ligji, është mirë që ministrat të jenë të pranishëm dhe t'i marrin sugjerimet e deputetëve për arsye se draftimi i ligjeve një herë bëhet në Ministri, e pastaj vjen në Kuvendin e Kosovës.

Ministër, ju e cekët se rekomandimin e parë, të cilin e ka nxjerrë Komisioni Parlamentar për Ligjin për ndërmarrjet publike, që ju e keni në strategjinë legjislative, besoj që kësaj radhe nuk do të jetë vetëm plotësim-ndryshim i ligjit siç ka qenë pas përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë, por do të jetë një ligj ndoshta komplet i ri, në bazë të mundësive që i keni.

U tha edhe nga parafolësit që Qeveria t'ua kthejë përgjigjen komunave në lidhje me kërkesat e tyre për themelimin e ndërmarrjeve publike, gjë që është normale. Ministri edhe gjatë diskutimit publik brenda komisionit na ka dhënë sqarime. Ministria e Zhvillimit Ekonomik ta fuqizojë rolin e njësisë për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike në aspektin e mbikëqyrjes së ndërmarrjeve publike, si dhe në aspektin e ngritjes së kapaciteteve administrative dhe financiare. Kjo është gjë normale,

duhet të jepet rekomandim, në këtë rast Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, ndërsa si rekomandim i katërt: njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike, nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve.

Ne e kemi pasur raportin e ndërmarrjeve publike. Në raportin e vitit të kaluar thuhet se ne e kemi pasur një kënaqshmëri të mirë të konsumatorëve. Ata nuk kanë nevojë të na thonë ne që e kemi një kënaqshmëri të mirë të konsumatorëve, mirëpo një mekanizëm tjetër të kontraktohet nga njësia për ndërmarrjet publike dhe t'i jepet pasqyra reale.

Në këtë aspekt, ministër, unë do ta jap një sugjerim timin këtu për arsye se kam kërkuar brenda Komisionit Parlamentar që ndërmarrjet publike të auditohen nga një auditor i jashtëm dhe t'u jepet performansa e tyre se sa është duke u zbatuar një ligj i saktë për ndërmarrjet publike.

Konkurset për drejtorë të ndërmarrjeve publike të jenë në përputhje me ligjin në fuqi dhe të pasqyrojnë domosdoshmërinë e karakterit profesional të ndërmarrjeve publike, gjë që nuk ka ndodhur. Ne akoma, ministër, i kemi ndërmarrjet publike me borde të vazhduara dhe ku po shihet që performansa e tyre nuk është e mirë.

Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike në raportet e performansës të bordeve të rekomandojë për Qeverinë e Kosovës që të merren masa në bordet, të cilat nuk kanë performuar mirë. Unë kisha kërkuar nga ministri që kjo të shkojë direkt në Qeveri, sepse këtyre bordeve u ka skaduar mandati, me një rekomandim apo me një vendim t'u vazhdohet, tash të vijnë borde profesionale dhe të dallohen nëse janë borde profesionale apo borde politike.

Dhe, njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike të hartojë udhëzime të qarta për borde. Ju e dini mjaft mirë që deri me tani disa borde të ndërmarrjeve publike janë kompensuar dhe janë në rimbursim për menaxherë të lartë të ndërmarrjeve publike. Çështja e pagave përcaktohet nga preformansa e tyre dhe ne nuk kemi të drejtë se ata nuk paguhet nga buxheti i Kosovës, por paguhet nga mbledhja e konsumit të tyre. Dhe, është e pasqyrave të kompensimit të mos bëhet në mënyrë të parregullt.

Koalicioni për Kosovë të Re i përkrah rekomandimet dhe njëkohësisht edhe një herë ministër kërkoj nga ju që gjatë draftimit të ligjit të thuhet saktë se do të ketë një auditor. Besoj që edhe ju jeni i këtij mendimi - një auditor i jashtëm për ndërmarrjet publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Marinković, në emër të Grupit Parlamentar "Zajednička Budućnost".

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

I poslanička grupa Zajednička Budućnost" je razmatrala izveštaj Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju u vezi nadgledanja sprovođenja Zakona o javnim preduzećima, i podržao izveštaj Komisije.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: E kam lexuar raportin, por ajo çka nuk kam gjetur në raport, u përmend edhe nga parafolësit, nuk është thënë që në Ligjin e ndërmarrjeve publike është shkelur nga Qeveria neni 9, pikërisht paragrafi 1, i cili ka të bëjë me shitjen e aksioneve të ndërmarrjeve publike. Kjo u tha edhe më herët.

I nderuari zoti ministër,

Ju e keni shkelur këtë ligj! Ju dhe paraardhësi i juaj, sepse Qeveria e ka formuar Komision Qeveritar për Privatizim. Ky vendim është dashur të silltet në Kuvend dhe të aprovohet me shumicë të thjeshtë, gjë në të cilën ju keni dështuar dhe në këtë formë e keni shkelur ligjin. Dhe, ky ligj po shkelet edhe sot e kësaj dite, përderisa nuk anulohet procesi i privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së.

Mirëpo, ajo çka është edhe më e turpshme nga ju, nga Qeveria juaj, është që shkeljen e një ligji ju po mundoheni ta mbulonit me shkeljen e ligjit tjetër, që është Ligji i buxhetit. Nuk e di se si keni fytyrë sot, pas amendamentit që e keni dërguar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, të vini dhe ta mbronit zbatueshmërinë e Ligjit për ndërmarrjet publike.

E keni sjell një nen në Ligjin e buxhetit për vitin 2014, i cili thotë me aprovimin e Ligjit të buxhetit konsiderohet i aprovuar edhe raporti i Komisionit Qeveritar të Privatizimit. Kjo është e tepërt! Kjo është e turpshme!

Definitivisht, unë nuk e di ku doni ta çoni popullin ju me gjëra të tilla. Me Ligjin e buxhetit po kërkon ta aprovojë raportin e Komisionit Qeveritar, për të cilin asnjëherë nuk ke mundur t'i kesh të pranishëm, nuk ke mundur t'i futësh brenda 61 deputetë. Kjo e tregon forcën, kompetencën, mënyrën e qeverisjes së Qeverisë së kryeministrit Thaçi. Kjo i tregon fytyrat tuaja të vërteta!

Dhe, këtu shpresoj që ne duhet të ngrihemi në këmbë të gjithë dhe të ju tregojmë qytetarëve të Kosovës se si po qeveriset me pasurinë e tyre, si po shkelen ligjet, të cilat po i aprovon ky Kuvend. Kjo është e turpshme dhe shpresoj që ke ndonjë justifikim nëse ekziston diku, të na japësh sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Mendoj që ato që i thanë kolegët e mi qëndrojnë plotësisht dhe mendoj që kjo nuk është hera e parë që Qeveria tenton që me manipulimet nëpërmjet buxhetit t'i mbulojë të gjitha ato të cilat nuk tenton t'i kryejë në mënyrën e rregullt ashtu qysh është kërkuar privatizimi i Postës, e është kërkuar sipas ligjeve, që së pari të lejojë Kuvendi, dhe pastaj të vazhdojnë procedurat.

Por, unë dëshiroj të prek edhe një çështje tjetër. Dëshiroj të prek monitorimin e zbatimit të Ligjit për ndërmarrje publike, të cilin e ka ndërmarrë komisioni ynë dhe gjatë analizës është bërë edhe dëgjimi publik dhe është ardhur deri te kërkesa që komunat e reja kërkojnë një trajtim tjetër, një trajtim, i cili do të duhej që të vijë si plotësim-ndryshim.

Gjithashtu, bordet të skaduara u përmendën dhe mendoj që edhe ato e kërkojnë një vëmendje të veçantë. Masat për performim jo të mirë të bordeve nuk janë të analizuara dhe nuk janë të trajtuara si duhet në këtë ligj.

Prandaj, si rekomandim i Komisionit për Zhvillim Ekonomik ishte edhe kërkesa për plotësim-ndryshimin e këtij ligji, ku këto gjëra do të futeshin si amendamente, si ndryshime në ligj.

Por, në anën tjetër, dëshiroj të cek se Parlamenti Evropian e ka aprovuar një rezolutë për kuotën gjinore në ndërmarrjet publike. Ajo rezolutë është e re, nuk ka shumë kohë që është aprovuar. Por, dëshiroj ta rikujtoj Kuvendin që edhe në marsin e vitit 2012, Kuvendi i Kosovës, në një seancë kur është folur për pozitën e gruas, ka sjellë rekomandime të cilat janë aprovuar pa asnjë votë kundër dhe njëri prej rekomandimeve ishte që të kërkohej zbatimi i Ligjit për barazinë gjinore nëpër bordet e ndërmarrjeve publike, gjë e cila nga kjo analizë ka treguar që ky ligj nuk ka fare zbatim nëpër ato borde.

Në kohën kur e kemi pasur dëgjimin publik kam kërkuar në mënyrë eksplicite që të bëhet zbatimi i Ligjit të barazisë gjinore edhe në bordet e ndërmarrjeve publike.

Prandaj, Komisioni për Zhvillim Ekonomik ka kërkuar që në strategjinë legjislativë për vitin 2014 të sillet në plotësim-ndryshim edhe Ligji i ndërmarrjeve publike dhe besoj që kjo rezolutë e Parlamentit Evropian dhe e rekomandimeve të Kuvendit të Kosovës duhet të jetë pjesë e përfshirë në këtë ligj të ri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Unë për veten time nuk isha i disponuar që të marr pjesë në diskutimet në këtë temë, por më zgjuan nga apatia dhe më nxorën nga indiferenca diskutimet dhe akcentet, të cilat nuk do të duhej ta karakterizojnë opozitën këtu në këtë sallë dhe në këtë Kuvend. Është krejt e arsyeshme që opozita ta luajë rolin e vet dhe natyrisht t'i sulmojë edhe t'i atakojë programet qeveritare, natyrisht edhe ta begatojë çdo projektligj që ofrohet këtu dhe ta plotësojë çdo mangësi që mund të jetë e pasqyruar dhe ofruar nga Qeveria.

Por, me këtë rast, kur dëgjojmë ndonjë përgatitje akademike, kur shohim performansë profesionale, kur prezantohen erudicione, të cilat e lënë pa gojë edhe kundërshtarin, natyrisht se të ngjallin zili, të shfaqin dhe të imponojnë për respekt.

Por, këto karaktere nuk duhet të ngarkohen me mocione negative dhe me shprehje të energji, të cilat nuk janë karakteristike për një kuvendar, aq më keq dhe aq më pak kur e kemi një performansë dhe një qasje profesionale dhe ngarkesat me energji negative dominojnë.

Këtu, në këtë rast, i kisha lutur të gjithë kolegët dhe koleget deputete që ta ofrojnë ekspertizën e tyre profesionale. Akëcili prej atyre që diskuton për tema të diskutueshme, por mundësisht edhe opinionin mbarë, edhe ne të na kursejnë nga emocionet, të cilat nuk japin rezultate dhe nuk afrojnë respekt.

Me këtë dua të përmbledh si sugjerim dashamirës dhe si një preferim kolegial që të kontribuojmë në cilësinë e punimeve dhe të diskutimeve tona këtu në këtë Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, replikë.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

Edhe unë e lus zotin Krasniqi të na kursejë prej poezive të tij se Kuvendi nuk është për të bërë poezi. Të lutem shumë, nuk është Kuvendi për të bërë poezi! Kur vidhen milionat, nuk ka tjetër, këtu duhet të luhet me emocione. Me emocione se s'ka mbetur tjetër mënyrë me ju për t'u marrë vesh. Lëri poezitë kur të shkosh në Malishevë, atje këndojua rrigrave!

KRYESUESI: Zoti Pajaziti e ka fjalën. Replikë bëri Haliti, nuk bëri ajo. Ajo bëri kundër-replikë.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe një herë dëshiroj të falënderoj edhe për kontributin këtu në seancë, edhe për emocionet e dhuruara. Pse jo, është në interes nganjëherë, pas një dite të lodhshme.

Megjithatë, dëshiroj të them që gjatë gjithë kohës sa është punuar në komisionin për monitorimin e zbatimit të këtij ligji, që është një ndër ligjet që po ashtu ka qenë i diskutueshëm për vetë faktin e funksionimit të ndërmarrjeve publike, të gjithë deputetët e partive politike e kanë pasur rastin ta japin kontributin e tyre për gjithçka që ka qenë pjesë e ligjit.

Ne mund ta shtrojmë edhe çështjen e privatizimit të Postës sa herë që duam edhe në pikat tjera, por është mirë t'i përmbahemi agjendës dhe ju ftoj edhe një herë që këto rekomandime, të cilat janë bërë bashkërisht, të aprovohen nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Në sallë janë 67 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

